



SHOQËRIA AKSIONARE DHE RREGULLIMI LIGJOR I SAJ SIPAS
LEGJISLACIONIT SHQIPTAR NË KRAHASIM ME ATË ITALIAN

TEZA E MASTERIT

ANISA BULLARI

EPOKA UNIVERSITY
FACULTY OF LAW AND SOCIAL SCIENCES
DEPARTMENT OF LAW

TIRANA, ALBANIA
QERSHOR 2023

**SHOQËRIA AKSIONARE DHE RREGULLIMI LIGJOR I SAJ SIPAS
LEGJISLACIONIT SHQIPTAR NË KRAHASIM ME ATË ITALIAN**

ANISA BULLARI

Tezë e dorëzuar në përputhje të plotë me kërkesat për gradën
Master i Shkencave në Drejtësi

EPOKA University

QERSHOR 2023

APPROVAL PAGE

Student Name and Surname: Anisa Bullari

Faculty: Faculty of Law and Social Sciences

Department: Department of Law

Thesis Title: Shoqëria aksionare dhe rregullimi ligjor i saj sipas legjislacionit shqiptar në krahasim me atë italian

Joint stock company and its legal regulation according to albanian legislation in comparison with italian legislation

Date of Defense: 15.07.2023

I certify that this final work satisfies all the requirements as a Master's Thesis for the degree of Master of Science in Law.

Dr. Niuton Mulleti

Acting Head of Department

I certify that I have read this final work and that in my opinion it is fully adequate, in scope and quality, as a Master Thesis for the degree of Master's in Science in Law.

Dr. Gelande Shkurtaj

Supervisor

Examination Committee Members

Title / Name & Surname	Affiliation	Signature
1. Dr. Gelande Shkurtaj	EPOKA University	
2. Dr. Alba Gërdeci	EPOKA University	
3. Prof. Dr. Endri Papajorgji	EPOKA University	

SHOQËRIA AKSIONARE DHE RREGULLIMI LIGJOR I SAJ SIPAS LEGJISLACIONIT SHQIPTAR NË KRAHASIM ME ATË ITALIAN

ABSTRAKT

Shoqëria aksionare është një lloj organizimi që lejon akumulimin dhe shpërndarjen efikase të kapitalit, si dhe përgjegjësinë e kufizuar për aksionarët. Rregulloret ligjore janë thelbësore për të siguruar funksionimin e duhur të shoqërive aksionare dhe sistemet ligjore shqiptare dhe italiane ofrojnë qasje të ndryshme për rregullimin e tyre. Ky punim synon të analizojë kuadrin ligjor të shoqërive aksionare në Shqipëri dhe Itali, duke krahasuar dhe identifikuar karakteristikat e tyre kryesore dhe dallimet rregullatore. Studimi fillimisht jep një pasqyrë të konceptit të shoqërisë aksionare dhe historisë së saj, e ndjekur nga një analizë e hollësishme e rregullimit ligjor të shoqërive aksionare në Shqipëri dhe Itali. Analiza përfshin një krahasim të kërkesave formale për krijimin dhe funksionimin e një shoqërie aksionare, rolin dhe përgjegjësitë e aksionarëve, strukturën e qeverisjes dhe kuadrin rregullator për bashkimet dhe blerjet. Studimi shqyrton gjithashtu mjetet juridike në dispozicion të aksionarëve dhe mekanizmat për mbrojtjen e të drejtave të aksionarëve të vegjël. Së fundi, punimi vlerëson efektivitetin e kuadrit ligjor në çdo vend dhe identifikon fushat e mundshme për përmirësim. Studimi nxjerr në pah dallime të rëndësishme në rregullimin ligjor të shoqërive aksionare në Shqipëri dhe Itali, ku sistemi italian ofron rregullime më të gjera dhe të detajuara. Megjithatë, sistemi ligjor shqiptar ka bërë progres të dukshëm vitet e fundit, duke e përafëruar kuadrin ligjor me standardet e Bashkimit Evropian.

Gjetjet e këtij studimi mund të jenë me interes për praktikuesit, politikëbërësit dhe studiuesit e interesuar në analizën krahasuese të kuadrit ligjor për shoqëritë aksionare.

Fjalë kyçe: shoqëria aksionare, kapital, bashkim, blerje, kuota

JOINT STOCK COMPANY AND ITS LEGAL REGULATION ACCORDING TO ALBANIAN LEGISLATION IN COMPARISON WITH ITALIAN LEGISLATION

ABSTRACT

A joint stock company is a type of organization that allows efficient accumulation and distribution of capital, as well as limited liability for shareholders. Legal regulations are essential to ensure the proper functioning of joint stock companies and the Albanian and Italian legal systems offer different approaches to their regulation. This paper aims to analyze the legal framework of joint stock companies in Albania and Italy, comparing and identifying their main characteristics and regulatory differences. The study first provides an overview of the concept of the joint stock company and its history, followed by a detailed analysis of the legal regulation of joint stock companies in Albania and Italy. The analysis includes a comparison of the formal requirements for the creation and operation of a joint stock company, the role and responsibilities of shareholders, the governance structure and the regulatory framework for mergers and acquisitions. The study also examines the legal remedies available to shareholders and the mechanisms for protecting the rights of minority shareholders. Finally, the paper assesses the effectiveness of the legal framework in each country and identifies potential areas for improvement. The study highlights important differences in the legal regulation of joint stock companies in Albania and Italy, where the Italian system offers more extensive and detailed regulations. However, the Albanian legal system has made significant progress in recent years, aligning the legal framework with the standards of the European Union. The findings of this study may be of interest to practitioners, policy makers and researchers interested in the comparative analysis of the legal framework for joint stock companies.

Keywords: joint stock company, capital, merger, purchase, quotas.

FALENDERIME

Ky punim finalizon 5 vite sfiduese studimi, duke mbyllur përfundimisht ciklin e të qënurit studente. Ndaj, e shoh mëse të arsyeshëm falenderimin e disa personave, ndikimi pozitiv i të cilëve më ka shoqëruar gjatë gjithë këtij rrugëtimi.

Si fillim dua të falenderoj thellësisht profesoreshën time Dr.Gelanda Shkurtaç, e cila më ka udhëhequr akademikisht jo vetëm gjatë punimit të kësaj teme, por edhe përgjatë viteve të mia të studimit.

Falenderoj gjithashtu të gjithë stafin akademik të universitetit “Epoka” që me profesionalizmin e tyre kanë dhënë një kontribut të pamohueshëm në formimin tim të përgjithshëm.

Një mirënjohje e përzemërt i shkon gjithashtu familjes time të madhe, në veçanti dy prindërve të mi, të cilët nuk do harroj t’i përmend në çdo arritje apo sukses timin për të gjitha sakrificat që kanë bërë për mua.

I jam pafundësisht mirënjohëse edhe grupit tim shoqëror jo vetëm për suportin emocional por edhe sepse më kanë bërë t’i dua më shumë ditët tek Epoka, duke e shndërruar këtë rrugëtim në një eksperiencë të paharrueshme.

Së fundmi, por absolutisht jo nga rëndësia, i shpreh falenderime gocave të mia, Anxhela, Nadia, Ketii, Ina dhe Enki, për inkurajimin në çdo hap që kam hedhur.

Faleminderit!

DEKLARATA E AUTORËSISË

Ky punim është një punim origjinal, ku janë respektuar të gjitha rregullat akademike dhe shkencore të shkrimit. Përveç rasteve të referimeve dhe citimeve të çdo autori, burimi i të cilëve është përcaktuar edhe në bibliografi, punimi nuk përmban materiale të publikuara më parë nga njerëz të tjerë.

TABELA E PËRMBAJTJES

SHOQËRIA AKSIONARE DHE RREGULLIMI LIGJOR I SAJ SIPAS LEGJISLACIONIT SHQIPTAR NË KRAHASIM ME ATË ITALIAN	iii
ABSTRAKT	iii
ABSTRACT	IV
FALENDERIME	V
DEKLARATA E AUTORËSISË	VI
HYRJE	1
Qëllimi i punimit	4
Objektivat e punimit	5
Pyetjet kërkimore	5
Metodologjia	6
KAPITULLI I	8
KONCEPTET KRYESORE MBI SHOQËRITË AKSIONARE	8
1.1. Koncepti i shoqërisë aksionare	8
1.2. Historiku dhe lindja e shoqërive aksionare.....	9
1.3. Karakteristikat e përgjithshme të shoqërive aksionare	10
KAPITULLI II	15

SHOQËRIA AKSIONARE SIPAS LEGJISLACIONIT SHQIPTAR	15
2.1. Parashikimet ligjore të shoqërisë aksionare në Shqipëri	15
2.1.1. Llojet e kontributeve.....	18
2.1.2. Llojet dhe kategoritë e aksioneve	20
2.3. Marrëdhëniet midis shoqërisë dhe aksionerëve.....	22
2.4. Organet e shoqërisë aksionare sipas ligjit.....	24
2.5. Përfaqësimi në asamble në shoqëritë aksionare	26
2.6. E drejta e votës dhe mënyra e votimit në shoqërinë aksionare sipas legjilacionit shqiptar	28
2.7. Administratori dhe këshilli mbikqyrës në sistemin me një nivel	29
2.8. Administratori dhe këshilli mbikqyrës në sistemin me dy nivele	32
KAPITULLI III	36
SHOQËRIA AKSIONARE SIPAS LEGJISLACIONIT ITALIAN	36
3.1. Karakteristikat ligjore të shoqërisë aksionare sipas legjislacionit Italian.....	36
3.2. Organet e shoqërisë aksionare sipas legjislacionit Italian	38
3.3. Aksionet dhe ndarja e tyre sipas legjislacionit Italian	42
3.4. Përfaqësimi dhe struktura e shoqërive aksionare sipas legjislacionit Italian.....	43
KAPITULLI IV	45
DALLIMET DHE TË PËRBASHKËTAT/PROBLEMATIKAT E RREGULLIMIT TË SHOQËRIVE AKSIONARE SIPAS DY SISTEMEVE LIGJORE	45
5.1. Dallimet midis dy sistemeve lidhur me shoqërinë aksionare	45
5.2. Problematikat e identifikuara lidhur me rregullimin dhe veprimtarinë e shoqërive aksionare në dy vendet	48
BIBLIOGRAFIA	55

HYRJE

Shoqëria aksionare është një lloj organizimi gjerësisht i përdorur në Shqipëri dhe jo vetëm. Me kalimin e viteve në vendin tonë rregullimi ligjor i shoqërisë aksionere u zhvillua dhe u përditësua. Për herë të parë, në vitin 1931 u trajtua më gjerësisht koncepti i shoqërisë tregtare si një entitet juridik në Kodin tregtar dhe ligjin për aplikimin e tij në Shqipëri. Ky Kod tregtar, i njohur ndryshe si Kodi tregtar i mbretit Zog, u botua më 5 mars 1932 dhe u konsiderua si një kornizë ligjore e plotë për veprimtarinë e tregtarëve dhe shoqërive tregtare. Për krijimin e tekstit, janë analizuar burime ligjore të vendeve të zhvilluara perëndimore të kohës për të gjetur modele të përshtatshme të legjislacionit. Kodet tregtare dhe ligjet për zbatimin e tyre janë trajtuar me hollësi për të mbuluar të gjitha llojet e shoqërive tregtare, organet drejtuese, asamblejat, administratorët, si dhe procedurat për largimin dhe përjashtimin e ortakëve (Zogut, 1932). Dispozitat më të reja trajtojnë institutet, të cilët ishin persona të emëruar personalisht nga principalët për ushtrimin e veprimtarisë tregtare në një degë ose në disa vende (Neni 107 i Kodit tregtar të Zogut dhe ligjit për zbatimin e tij). Në periudhën e regjimit totalitar, të drejtat tregtare gradualisht u kufizuan vetëm në format e ndërmarrjeve shtetërore dhe korporatave të asaj kohe. Aktiviteti privat në fushën e tregtisë ishte i ndaluar. Pas vendosjes së demokracisë në Shqipëri, sistemi ligjor shqiptar filloi të pasurohet me ligje dhe akte të reja për të rregulluar veprimtarinë tregtare dhe promovuar zhvillimin e sektorit privat.

Në vitet pas viteve '90, u ndërmorën hapa të rëndësishëm për të krijuar një mjedis më të favorshëm për tregtinë dhe biznesin në vend. Në vitin 1992, u miratua Kodi Tregtar i Republikës së Shqipërisë, i cili zëvendësoi Kodin tregtar të mbretit Zog. Ky Kod u hartua duke u bazuar në modele legjislacionesh të vendeve të zhvilluara dhe u përshtat për të përfshirë aspektet e reja të tregtisë dhe biznesit modern. Nëpërmjet Kodit Tregtar të vitit 1992 dhe ligjeve të krijuara në vitet pasuese, u vendos baza ligjore për themelimin dhe funksionimin e shoqërive tregtare, duke përfshirë shoqëritë me përgjegjësi të kufizuar dhe

shoqëritë aksionare. Ligjet e reja rregulluan gjithashtu aspektet e tregtisë elektronike, konkurrencën, mbrojtjen e konsumatorit, pronësinë intelektuale dhe shumë aspekte të tjera të veprimtarisë tregtare.

Gjatë viteve të fundit, qeveria shqiptare ka vënë në vend politika dhe masa të ndryshme për të promovuar investimet dhe zhvillimin e biznesit. Krijimi i ambienteve efikase për bizneset, reduktimi i burokracisë, përmirësimi i klimës së investimeve, si dhe ndihma dhe stimulimi për bizneset janë disa prej fushave të veçanta në të cilat janë ndërmarrë veprime. Përveç Kodit Tregtar, ekzistojnë edhe ligje të tjera të rëndësishme që rregullojnë aspektet tregtare në Shqipëri, si ligji për tatimin mbi fitimin, ligji për titujt, ligji i konkurrencës, kodi i punës, ligji i procedurave tatimore, ligji për AMF-në etj. Një ligj i rëndësishëm është Ligji Nr. 9723, datë 03.05.2007, "Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit", i cili ka ndikuar në aspektet ligjore të shoqërive tregtare në Shqipëri. Ligji i ri ripërcakton kategoritë e shoqërive tregtare si shoqëritë kolektive, shoqëritë komandite, shoqëritë me përgjegjësi të kufizuar dhe shoqëritë aksionare. Këtu vërehet një ndryshim në emërtimin e shoqërive që më parë quheshin shoqëri anonime dhe tani quhen Shoqëri Aksionare (SHA). Ligji përcakton në mënyrë të përgjithshme procedurat e themelimit të shoqërive aksionare dhe referon për elementë të ndryshëm, siç është përmbajtja e statutit, tek Ligji Nr. 9723, datë 03.05.2007, "Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit". Ligji vendos parimet kryesore të funksionimit të shoqërive tregtare, duke i dhënë rëndësi të veçantë detyrimit të besnikërisë. Transparenca e veprimtarisë së shoqërive tregtare garantohej nga e drejta e informimit që ortakët ose aksionerët kanë ndaj personave përgjegjës për administrimin e shoqërisë (Ligji Nr. 9723). Përveç ligjeve të përmendura më sipër, Ligji i ri Nr. 9901, datë 14.04.2008, "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", sjell inovacione të reja për zhvillimin, funksionimin dhe administrimin e shoqërive aksionare. Ky ligj ka për qëllim përmirësimin e mjedisit tregtar dhe promovimin e stabilitetit në sektorin e biznesit. (Ligji Nr. 9901, "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", I ndryshuar.) Gjithashtu një ligj shumë i rëndësishëm është ai për titujt i cili përfshin aksionet, obligacionet e shoqërive tregtare dhe enteve vendore, bonot e thesarit, obligacionet, titujt e lëshuar nga Banka e Shqipërisë, dëftesat tregtare, aksionet dhe kuotat e fondeve të investimeve, si dhe instrumente të tjera financiare. (3, Ligjit Nr. 9897, datë 21.02.2008, "Për Titujt".)

Pas ardhjes së demokracisë, Shqipëria ka bërë përpjekje për të harmonizuar ligjet e saj tregtare me standardet dhe direktivat e Bashkimit Europian, duke u bërë anëtare e KE-7 (Rajoni i Procesit të Stabilizim-Asociimit) në vitin 2006 dhe duke filluar negociatat për

anëtarësimin në vitin 2020. Kjo ka ndikuar në ndryshimet e mëtejshme të sistemit ligjor shqiptar për të përshtatur me standarde ndërkombëtare.

Në krahasim, ligji italian rregullon shoqëritë aksionare nëpërmjet Kodit Civil dhe Dekretit Legjislativ nr. 58/1998, i cili zbaton direktivat e Bashkimit Evropian për tregjet e letrave me vlerë. Ligji italian parashikon rregulla strikte për zbulimin e informacionit, mbledhjet e aksionarëve dhe rolin e bordit të Administratorëve. Këto rregullore sigurojnë një nivel të lartë transparence dhe llogaridhënieje, gjë që është thelbësore për tërheqjen e investimeve të huaja dhe ruajtjen e besimit të investitorëve. Shoqëria aksionare në Itali mund të themelohet me akt të njëanshëm ose me marrëveshje; në të dyja rastet është i nevojshëm hartimi i aktit të themelimit, i cili është një lloj karte identiteti i shoqërisë, dhe statuti, i cili përmban rregullat për funksionimin e shoqërisë. Në rast se përmbajtja e dy dokumenteve është në kontrast me njëra-tjetrën, do të mbizotërojë statuti. Formimi i shoqërisë aksionare zhvillohet në dy faza:

- hartimi i aktit të themelimit (atto costitutivo);
- regjistrimi në Regjistrin e Shoqërive.

Për të vazhduar në mënyrë të vlefshme themelimin e shoqërisë aksionare, është gjithashtu e nevojshme të verifikohen:

- nënshkrimi i kapitalit aksionar;
- pagesën e 25% të kontributeve në para dhe respektimin e dispozitave të kodit civil për kontributet e mallrave në natyrë dhe në kredi;
- ekzistimin e autorizimeve të qeverisë dhe kushteve të tjera që mund të kërkohen nga ligjet e veçanta për të mundësuar krijimin e shoqërisë, në lidhje me objektin e saj specifik.

Nënshkrimi i kapitalit të shoqërive aksionare mund të bëhet edhe me garanci bankare ose polic sigurimi. Nënshkrimi i aktit të themelimit (atto costitutivo) duhet të bëhet domosdoshmërisht, me akt publik noterial, i cili mund të jetë:

- a) i njëkohshëm: ku aksionarët aspirantë nënshkruajnë njëkohësisht aktin para noterit (është mënyra më e zakonshme e inkomporimit);
- b) të mëvonshme: ose me abonim publik, në të cilin themelimi bëhet në fund, si përfundim i një serie mbledhjesh.

Pra duke marrë parasysh rregullimin ligjor të të dyja vendeve, shohim se kemi dallime mes tyre, por dhe karakteristika të cilat janë të ngjashme.

Nevoja e trajtimit të kësaj teme lind nga rëndësia e shoqërive aksionare në zhvillimin ekonomik të Shqipërisë dhe Italisë. Kuptimi i kuadrit ligjor që rrethon këto njësi është thelbësor për investitorët, sipërmarrësit dhe politikëbërësit. Një analizë krahasuese e rregullimit ligjor në Shqipëri dhe Itali mund të nxjerrë në pah fushat ku nevojiten përmirësime dhe të sigurojë njohuri mbi praktikatat më të mira për rregullimin e shoqërive aksionare. Kjo mund të çojë në rritjen e investimeve, rritjes ekonomike dhe krijimit të vendeve të punës në të dy vendet.

Ky punim jep një pasqyrë të shkurtër të rëndësisë së shoqërive aksionare në ekonomitë moderne dhe thekson rëndësinë e rregullimit ligjor në duke siguruar funksionimin e duhur të tyre. Në hyrje parashtrohet edhe qëllimi i punimit, i cili është të krahasojë dhe analizojë kuadrin ligjor për shoqëritë aksionare në Shqipëri dhe Itali.

Qëllimi i punimit

Qëllimi i këtij punimi është të trajtojë në nivel sa më të lartë karakteristikat kryesore të një shoqërie aksionare, duke përfshirë jo vetëm të drejtën kombëtare shqiptare, por edhe të drejtën italiane. Ky punim, aplikon një metodë krahasuese si dhe një qasje kombëtare dhe evropiane. Gjithashtu, një qasje ndërdisiplinore është e rëndësishme sepse në një botë moderne, qasja juridike ndikon në shkencat e tjera, ashtu siç dhe shkencat e tjera sociale, ndikojnë pozitivisht në kodifikimin apo interpretimin e koncepteve juridike. Pra, ky punim ka një qasje jo vetëm historike, juridike, krahasuese apo kritike, por edhe ndërdisiplinore. Teza ka si qëllim edhe që të nënvizojë rëndësinë e qasjes së konceptit të shoqërive aksionare në Itali për të kuptuar më qartë legjislacionin aktual. Gjithashtu, dhe më e rëndësishme, teza aplikon një qasje krahasuese, për aq sa kjo është shumë e rëndësishme në një shtet si Shqipëria, ku legjislacioni aktual, me parime demokratike, nuk ka një histori të gjatë si në rastin e shtetit italian.

Gjithashtu, ky analizim është i rëndësishëm për faktin se në Shqipëri –vetëm në shekullin XX –ka patur tre valë të ndryshme të tranzicionit: 1. Nga e drejta zakonore në të drejtën e shkruar në periudhën e Zogut; 2. Nga e drejta e shkruar në periudhën e Zogut në atë

komuniste; si dhe 3. Tranzicioni demokratik i harmonizimit të së drejtës shqiptare me atë të BE-së. Ndryshimet ndërmjet modeleve të ndryshme kulturore, të cilat ndikojnë në qeverisjen e Sh.A.-ve, paraqiten duke nënvizuar dhe rëndësinë e modelit tradicional italian.

Për të qenë një punim sa më inovativ dhe duke patur parasysh që literatura kombëtare nuk ka një analizim të detajuar, kjo tezë i kushton një vëmendje të veçantë disa ndryshimeve kyçe duke konkretizuar dhe doktrinën e huaj me dispozitat konkrete të ligjit nr. 9901, datë 14.04.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, i ndryshuar (ligji nr.9901/2008).

Objektivat e punimit

Objektivat e punimit janë të shqyrtojë legjislacionet e RSH dhe Italisë për themelimin dhe funksionimin e shoqërive aksionare, rolin dhe përgjegjësitë e aksionarëve, strukturën e qeverisjes dhe dallimet mes dy sistemeve të së drejtës lidhur me shoqëritë aksionare. Punimi synon gjithashtu të eksplorojë mjetet juridike në dispozicion të aksionarëve dhe mekanizmat për mbrojtjen e të drejtave të aksionarëve të vegjël.

Pyetjet kërkimore

Pyetjet kërkimore të trajtuara në punim përfshijnë:

1. Cilat janë kërkesat formale për krijimin dhe funksionimin e shoqërive aksionare në Shqipëri dhe Itali?
2. Cilat janë përgjegjësitë e aksionarëve dhe organeve të tjera sipas këtyre legjislacioneve?
3. Cilat janë kornizat rregullatore mbi shoqërinë aksionare në Shqipëri dhe Itali?
4. Cilat mjete juridike janë në dispozicion të aksionarëve dhe çfarë mekanizmesh ekzistojnë për mbrojtjen e të drejtave të aksionarëve pakicë?
5. Ku dallojnë dhe cilat janë të përbashkëtat e dy sistemeve mbi shoqëritë aksionare në Shqipëri dhe Itali?

Metodologjia

Burimet e përdorura në punim përfshijnë legjislacionin e dy vendeve, praktikën gjyqësore dhe literaturën akademike mbi shoqëritë aksionare dhe të drejtën e korporatave në Shqipëri dhe Itali. Rëndësia e punimit qëndron në kontributin e tij në kuptimin e kuadrit ligjor për shoqëritë aksionare në Shqipëri dhe Itali dhe potencialin e tij për të informuar politikëbërësit dhe studiuesit e interesuar për të drejtën krahasuese të këtyre shoqërive.

Në shkencat juridike përdoren metoda të cilat, për nga natyra e profilit të kësaj shkence, nuk përfshijnë domosdoshmërisht realizimin e metodave sasiore, por kryesisht cilësore, ashtu si edhe në këtë rast. Ky punim përmban një shumëllojshmëri metodash kërkimore, duke përfshirë jo vetëm metodat kërkimore tradicionale të ligjit, por edhe metoda ndërdisiplinore. Gjithashtu, me qëllimin për të ndërtuar një punim shkencor sa më inovativ, teoritë e ndryshme doktrinale janë mbështetur me konkretizimin e ndryshimeve të kodifikimeve të dispozitave të ligjit nr.9901/2008. Për më tepër, kjo tezë përdor doktrinën e huaj për të analizuar, komentuar dhe kritikuar dispozita të ndryshme të ligjit kombëtar. Kjo qasje është bërë pasi kryesisht literatura shqiptare përbëhet nga një metodë deskriptive dhe jo analitike. Kjo tezë, ka aplikuar metodat historike duke e bërë këtë punim një kërkim shkencor, i cili mban një qëndrim kritik ndaj histories së zhvillimit të shoqërive aksionare, pa harruar rëndësinë e zhvillimit historik të së drejtës. Me fjalë të tjera, e tashmja nuk mund të kuptohet pa patur parasysh kontekstin historiko-ligjor të këtyre shoqërive. Edhe në pjesën historike, megjithëse literatura kombëtare shqiptare mund të ishte jo shumë e volitshme, teza është përqendruar tek ndryshimet që hasen gjatë krahasimit në nivel evropian dhe kombëtar –si në Itali ashtu dhe në Shqipëri –duke qenë gjithmonë një punim specifik dhe jo i përgjithshëm.

Për më tepër, kjo tezë ka aplikuar metoda krahasuese. Vetë struktura e këtij punimi nënkupton krahasimin e bërë: ligji italian dhe ligji kombëtar shqiptar. Ligji italian është marrë si shembull sepse literatura ka treguar se ka një bashkëpunim kulturor, ekonomik, shkencor dhe ligjor ndërmjet Shqipërisë dhe Italisë. Gjithashtu, Italia është një nga vendet themeluese të BE-së. Shqipëria është marrë si shembull sepse është shteti ballkanik me qasjen pozitive më të lartë për anëtarësimin në BE, ku

ligji kombëtar është huazuar jo vetëm nga legjislacioni evropian – që është bazuar tek legjislacioni anglez dhe gjerman –por edhe ai italian.

KAPITULLI I

KONCEPTET KRYESORE MBI SHOQËRITË AKSIONARE

1.1.Koncepti i shoqërisë aksionare

Koncepti i shoqërisë aksionare, i njohur edhe si shoqëri, është analizuar nga studiues të shumtë të fushës të së drejtës gjatë historisë. Këtu janë disa këndvështrime nga autorë të ndryshëm në fushën e së drejtës:

Adam Smith: Në librin e tij "Pasuria e Kombeve", argumentoi se shoqëria aksionare ishte një mjet i rëndësishëm për rritjen dhe zhvillimin ekonomik. Ai e shihte shoqërinë aksionare si një mjet për të mobilizuar shuma të mëdha kapitali nga investitorët që mund të merrnin pjesë në fitimet pa u përfshirë drejtpërdrejt në menaxhimin e kompanisë. (Smith, 1776)

John Stuart Mill: E shihte shoqërinë aksionare si një mënyrë për të promovuar efikasitetin ekonomik dhe përparimin shoqëror. Ai argumentoi se mbrojtja me përgjegjësi të kufizuar që u ofrohet aksionerëve inkurajoi investimet dhe sipërmarrjen, të cilat nga ana e tyre çuan në rritje ekonomike dhe përmirësim të standardeve të jetesës. (Mill, 1848)

Charles Clark: një studiues amerikan i së drejtës të shekullit të 19-të, e pa shoqërinë aksionare si një entitet juridik unik që ishte i ndarë nga aksionarët e saj individualë. Ai argumentoi se forma e shoqërisë lejonte një fleksibilitet më të madh në operacionet e biznesit dhe ofronte një mjet për aksionarët për të kufizuar përgjegjësinë e tyre në rast të dështimit të biznesit. (Clark, 1891).

Adolf dhe Gardiner: Në librin e tyre me ndikim "The Modern Corporation and Private Property", argumentuan se shoqëria aksionare ishte bërë një institucion i fuqishëm ekonomik që ishte i ndarë nga aksionarët e saj. (Berle, 1932)

Ronald Coase: një ekonomist dhe studiues fitues i çmimit Nobel, argumentoi se shoqëria aksionare ishte një shembull se si institucionet ligjore mund të formësojnë sjelljen ekonomike. Ai e pa formën e shoqërisë si një mënyrë për të kapërcyer kostot e larta të transaksioneve që lidhen me kryerjen e biznesit në një ekonomi tregu. (Coase, 1937)

Në përgjithësi, këta autorë dhe shumë të tjerë e kanë analizuar shoqërinë aksionare si një institucion kompleks ligjor dhe ekonomik me implikime të rëndësishme për rritjen ekonomike dhe progresin social.

1.2.Historiku dhe lindja e shoqërive aksionare

Historia e shoqërive aksionare daton në shekullin e 16-të, kur tregtarët evropianë filluan të bashkonin burimet e tyre për të financuar udhëtimet në distanca të gjata dhe ekspeditat tregtare jashtë shtetit. Në vijim, është paraqitur një pasqyrë e krijimit, lindjes dhe zhvillimit të shoqërive aksionare në vende dhe periudha të ndryshme historike:

Itali: Koncepti i shoqërisë aksionare u shfaq për herë të parë në Itali gjatë periudhës së Rilindjes, ku njihej si një kompani. Këto kompani të hershme zakonisht formoheshin për të financuar ekspedita tregtare në distanca të gjata dhe organizoheshin si partneritete midis tregtarëve që ndanin rreziqet dhe përfitimet e sipërmarrjes. (Bergamini, 2018)

Anglia: Shoqëria e parë aksionare në Angli ishte Muscovy Company, e cila u krijua në 1555 për të tregtuar me Rusinë. Kompania angleze e Indisë Lindore, e themeluar në vitin 1600, u bë një nga shoqëritë aksionare më të suksesshme të epokës, që krijoi monopol mes tregtisë angleze me Indinë dhe Lindjen e Largët. (Scott, 1911)

Holandë: Kompania Hollandeze e Indisë Lindore, e themeluar në vitin 1602, ishte një nga shoqëritë aksionare më të mëdha dhe më të fuqishme në histori. Ajo krijoi një monopol në tregtinë holandeze dhe Indinë Lindore ku kontrollonte një rrjet të gjerë portesh tregtare dhe kolonish në të gjithë Azinë. (Dale, 1973)

Shtetet e Bashkuara: Në Shtetet e Bashkuara, shoqëritë aksionare luajtën një rol të rëndësishëm në zhvillimin e ekonomisë së vendit gjatë shekullit të 19-të. Kompania e parë aksionare amerikane ishte kompania Massachusetts Bay, e cila u krijua në 1629 për të kolonizuar Botën e Re. Gjatë Revolucionit Industrial, shoqëritë aksionare ishin të rëndësishme në financimin e zhvillimit të teknologjive dhe industrive të reja, të tilla si hekurudhat, tekstilet dhe çeliku. (Markham, 2015)

Japonia: Shoqëria moderne aksionare japoneze, e njohur si kabushiki kaisha, u prezantua në fund të shekullit të 19-të si pjesë e përpjekjeve të vendit për të modernizuar ekonominë dhe sistemin ligjor. Sot, shoqëritë aksionare japoneze janë ndër korporatat më të mëdha dhe më me ndikim në botë. (Inagaki, 2013)

Në përgjithësi, krijimi, lindja dhe zhvillimi i shoqërive aksionare kanë qenë të lidhura ngushtë me rritjen dhe evolucionin e tregtisë ndërkombëtare, industrializimit dhe sistemeve moderne ekonomike.

1.3.Karakteristikat e përgjithshme të shoqërive aksionare

Shoqëria aksionare është shoqëria ku kapitali ndahet në aksione të transferueshme në pronësi të aksionarëve respektivë. Kuadri ligjor që rregullon shoqëritë aksionare ndryshon në varësi të juridiksionit të vendeve në të cilat ato janë themeluar. Në shumicën e vendeve, shoqëritë aksionare rregullohen nga ligji i shoqërive tregtare, i cili përcakton rregullat dhe kërkesat për formimin, funksionimin dhe shpërbërjen e tyre. Përveç ligjit për shoqëritë tregtare, shoqëritë aksionare i nënshtrohen edhe ligjeve të tjera, si ligjit për letrat me vlerë, ligjit tatimor, ligjit të punës dhe kornizave të tjera rregullatore që zbatohen për bizneset në përgjithësi. (Cheffins, 2014)

Struktura e pronësisë

Një nga karakteristikat kryesore të një shoqërie aksionare është struktura e saj e pronësisë. Shoqëritë aksionare janë në pronësi të aksionarëve, të cilët janë pronarë të kapitalit të shoqërisë. Aksionarët kanë përgjegjësi të kufizuar për borxhet dhe detyrimet e kompanisë, që do të thotë se asetet e tyre personale nuk janë në rrezik në rast të falimentimit të kompanisë. Aksionet e një shoqërie aksionare janë të transferueshme, që do të thotë se ato mund të blihen dhe shiten në bursa ose përmes transaksioneve private. (Diamond, 1984)

Menaxhimi

Menaxhimi i shoqërisë aksionare është i ndryshëm në vende të ndryshme. Në Shqipëri menaxhimi është i përcaktuar në mënyrë të shprehur në një sërë aktesh ligjore. Organizimi dhe funksionimi i Këshillit të Administrimit është i rëndësishëm për menaxhimin e aktiviteteve administrative, financiare, ekonomike dhe pronësore të një institucioni. Në një sistem me një nivel, administratorët e shoqërisë zgjidhen dhe shkarkohen nga Këshilli i Administrimit (Neni 158 i Ligjit "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregëtare").

Ndërsa në një sistem me dy nivele, administratorët mund të zgjidhen nga Këshilli Mbikëqyrës ose nga APA, sipas mënyrës së përcaktuar në statut. Mandati i tyre përcaktohet në statut për një periudhë maksimale prej tre vitesh. Megjithëse ligji nuk e përmend në mënyrë të qartë, interpretimi i dispozitave ligjore sugjeron se administratorët janë pjesë e numrit të përgjithshëm të anëtarëve të këshillit.

Kurse në Itali kemi:

1) Sistemi tradicional i administrimit të një sh.a ku organet menaxhuese janë:

- Administratori i vetëm ose bordi i administrimit;
- bordi i audituesve ligjorë dhe një auditues i jashtëm ose firmë auditimi të jashtëm.

2) Sistemi dualist i administrimit:

- një bord drejtues dhe një bord mbikëqyrës;
- sistemi monist parashikon një bord drejtues dhe një organ kontrolli.

Në çdo rast, Administratorët janë ata që përbëjnë organin drejtues të shoqërisë, me funksione të ndryshme themelore si:

- të diskutojë për menaxhimin e shoqërisë;
- të thërrasë mbledhjen e aksionarëve dhe të përcaktojë rendin e ditës;
- të hartojë pasqyrat financiare vjetore që do të paraqiten për miratim në mbledhje;
- të kujdeset për mbajtjen e librave kontabël;
- të mbikëqyrë punën e rregullt të menaxhimit të shoqërisë;
- të përfaqësojë shoqërinë ndaj të tretëve dhe në gjykatë;

- për të krijuar një raport mbi aktivitetin e shoqërisë. (Bussines, 2022)

Pra zakonisht shoqëritë aksionare menaxhohen nga një bord Administratorësh, i cili është përgjegjës për marrjen e vendimeve strategjike dhe mbikëqyrjen e operacioneve të kompanisë. Bordi i Administratorëve zgjidhet nga aksionarët dhe zakonisht përfshin një përzierje të Administratorëve ekzekutivë dhe joekzekutivë. Administratorët ekzekutivë janë përgjegjës për menaxhimin e përditshëm të kompanisë, ndërsa Administratorët joekzekutivë ofrojnë mbikëqyrje dhe udhëzime për ekipin ekzekutiv. Përveç bordit të Administratorëve, shoqëritë aksionare mund të kenë edhe një ekip drejtues që është përgjegjës për funksionet operative dhe administrative të biznesit. (Hermalin, 2012)

Për të siguruar zhvillimin e suksesshëm të një shoqërie aksionare ose çdo shoqërie tjetër, kapitali i saj është i rëndësishëm. Shpesh ndodh që për çështje të ndryshme, aksionarët vendosin të ndryshojnë kapitalin e tyre. Në disa raste, kapitali mund të rritet, ndërsa në raste të tjera mund të zvogëlohet. (Jensen, 1976) Rritja e kapitalit mund të ndodhë kur shoqëria ka nevojë për financim të menjëhershëm dhe vendos të emetojë aksione të reja tërheqjen e kapitalit nga aksionarët ekzistues ose të rinj. Kjo është një praktikë shumë e zakonshme për shoqëritë tregtare, por ka edhe raste të tjera si rritja e forcës së shoqërisë në treg, kur shoqëria duhet të plotësojë kriteret ligjore specifike për një treg të veçantë, si dhe arsye fiskale. Në disa raste, shoqëria mund të zvogëlojë kapitalin themelor, si në rastet kur akumulon humbje, kur dëshiron të zvogëlojë përgjegjësinë ndaj palëve të treta, apo kur duhet të anulohet aksionet sipas parashikimeve të ligjit dhe statutit. Pavarësisht arsyeve për ndryshimin e kapitalit, duhet treguar kujdes i veçantë për pasojat e kësaj veprimtarie ndaj palëve të treta, si kreditorët e shoqërisë. Kur kemi rritje të kapitalit rritjet proporcionalisht pjesëmarrja e aksionerëve dhe vlera e saj ndaj palëve të treta. Megjithatë, në rastet kur kapitali zvogëlohet, të drejtat e kreditorëve mund të preken.

Ligji për shoqëritë tregtare në Shqipëri kategorizon procedurat e ndryshme për rritjen e kapitalit në shoqëri. Përmenden pesë procedura të zakonshme për rritjen e kapitalit:

1. Rritja e kapitalit me emetimin e aksioneve të reja (Neni 200 i Ligjit "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare").
2. Rritja e kufizuar e kapitalit (Neni 175 i Ligjit "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare").
3. Rritja e autorizuar e kapitalit.

4. Rritja e kapitalit duke përdorur asetet e shoqërisë.

5. Rritja e kapitalit si rezultat i konvertimit të obligacioneve në aksione.

Rritja e kapitalit të shoqërive aksionare mund të bëhet përmes emetimit të aksioneve të reja me kontribute të reja ose duke paguar çmimin e blerjes së aksioneve të reja. Në legjislacionet europiane njihen dy mënyra të regjistrimit të kapitalit të shoqërive aksionare: përmes emetimit të aksioneve të reja dhe rritjes së vlerës së aksioneve ekzistuese, duke mos përfshirë hyrjen e re të aksionarëve në shoqëri.

Në Itali Shoqëria aksionare (S.p.A. ose Società per Azioni) krijohet me akt publik përpara një noteri, i cili regjistron aktin dhe regjistron shoqërinë në Regjistrin e Shoqërive për zonën (ai ku ndodhet selia). Korporatat krijohen vetëm nëse shoqëria regjistrohet nga noteri në Regjistruesin e Kompanive. Për krijimin e tij kërkon një kapital minimal prej 50,000 €, nga të cilat të paktën 25% e kapitalit aksionar (ekuivalent me 12,500 €) duhet të paguhet dhe kjo duhet të dokumentohet në statut. Për kompani të caktuara, ligji kërkon një kapital minimal më të lartë, në varësi të karakteristikave të aktivitetit të biznesit (p.sh. në rastin e firmave të letrave me vlerë ose bankave ose shoqërive financiare). Në rast se shoqëria krijohet vetëm me një ortak, duhet paguar shuma e plotë e kapitalit aksionar. Shoqëria aksionare mund të jetë dy lloje: e hapur, d.m.th. "publike" (shoqëritë e listuara me aksione të përhapura gjerësisht); dhe të mbyllura, të cilat nuk përdorin tregjet e kapitalit. Auditimi ligjor në një S.p.A kryhet nga një auditues ligjor ose nga një firmë auditimi të jashtëm. Në shoqëritë që nuk u kërkohet të përgatisin pasqyra financiare të konsoliduara, kjo veprimtari mund të kryhet nga Bordi i Audituesve, nëse kjo parashikohet shprehimisht në statut. Në rastin e shoqërive që miratojnë sistemin me një nivel ose dy nivele, auditimi duhet të kryhet gjithmonë nga një palë e jashtme (audituesi ligjor ose shoqëria audituese). Nuk është e nevojshme që pjesëmarrja në kompani të përputhet me "kontributet" fillestare të bëra nga çdo individ: për shembull, aksionarët mund të vendosin lirisht të "shpërblejnë" me më shumë aksione një aksionar, pjesëmarrja e të cilit konsiderohet strategjike ose kontributi aktiv i të cilit është thelbësor.

Gjithashtu qeverisja është një aspekt kyç i shoqërive aksionare, pasi ndihmon për të siguruar që kompania të menaxhohet në interesin më të mirë të aksionarëve të saj. Strukturat e qeverisjes ndryshojnë në varësi të madhësisë dhe kompleksitetit të kompanisë, por zakonisht përfshijnë një bord Administratorësh, një komitet auditimi dhe komitete të tjera që mbikëqyrin fusha specifike të biznesit. Shoqëritë aksionare i nënshtrohen

gjithashtu një sërë rregulloresh dhe standardesh që rregullojnë kërkesat e tyre për raportim dhe zbulim, si dhe detyrimet e tyre ndaj aksionarëve dhe palëve të tjera të interesuara. (Roe, 1994)

Shoqëritë aksionare janë një lloj entiteti biznesi që ofron një sërë avantazhesh për investitorët, duke përfshirë përgjegjësinë e kufizuar, pronësinë e transferueshme dhe aksesin në tregjet e kapitalit. Shoqëritë aksionare kanë luajtur një rol të rëndësishëm në rritjen dhe zhvillimin e ekonomive moderne dhe ka të ngjarë të vazhdojnë ta bëjnë këtë në të ardhmen.

KAPITULLI II

SHOQËRIA AKSIONARE SIPAS LEGJISLACIONIT SHQIPTAR

2.1. Parashikimet ligjore të shoqërisë aksionare në Shqipëri

Të gjithë parashikimet ligjore të përmendura në këtë kapitull kanë si bazë ligjore jo vetëm Ligjin Nr. 9901, datë 14.4.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", por edhe Ligjin nr. 129/2014 për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 9901, datë 14.4.2008, "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", të ndryshuar. Një shoqëri aksionare është një entitet tregtar, ku kapitali është ndarë në aksione të nënshkruara nga themeluesit, duke u bazuar në Ligjin Nr. 9901, datë 14.4.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare". Themeluesit e shoqërisë mund të jenë persona fizikë ose juridikë, dhe ata nuk janë të përgjegjshëm personalisht për detyrimet e shoqërisë, duke u kufizuar vetëm në vlerën e aksioneve të nënshkruara. Shoqëritë aksionare mund të jenë të klasifikuara si shoqëri me ofertë, private ose publike, në përputhje me rregullat e ligjit për titujt (Neni 105/2. Ligji Nr.9901, datë 14.4.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare").

Ligji rregullon dy forma të shoqërisë aksionare:

Shoqëria aksionare me ofertë publike: Kjo është forma e shoqërisë aksionare ku aksionet shpërndahen publikisht nëpërmjet bursave ose metoda të tjera ligjore. Kjo shoqëri ka nevojë për shtimin e kapitalit për të zgjeruar aktivitetet dhe përmirësuar teknologjinë, me qëllim që të konkurojë si një fuqi në treg. Një mënyrë për të rritur kapitalin është përmes emetimit dhe shitjes së letrave me vlerë nga ana e shoqërisë. Këto emetime të reja mund të jenë në formën e emetimeve të aksioneve ose obligacioneve, dhe zakonisht tregtohen në tregun primar, që është vendi ku ato ofrohen për shitje në publik (me një minimum prej

100 personash) ose përmes alokimit direkt, ku i ofrohen për shitje vetëm një grupi të vogël investitorësh të mëdhenj ose një numri të kufizuar investitorësh institucionalë.

1. Shoqëria aksionare me ofertë private: Kjo është forma e shoqërisë aksionare ku aksionet mbahen nga një numër i kufizuar aksionerësh. Shoqëritë aksionare emetojnë aksione dhe i nënshtrohen rregullave të emetimit, këmbimit, administrimit, tregëtimit dhe ligjit për titujt. Titujt janë instrumente financiare që emetohen dhe tregtohen për të siguruar fitim përmes të drejtave që rrjedhin nga zotërimi i tyre. Emetime të titujve mund të bëhen përmes ofertës publike ose private në Republikën e Shqipërisë ose jashtë saj. Oferta publike e titujve është një ftesë për të nënshkruar tituj, duke përdorur mjetet e komunikimit masiv që drejtohen drejt një numri të pacaktuar personash.

Në shoqëritë me ofertë private, oferta për të nënshkruar tituj drejtohet vetëm tek investitorët institucionalë, aksionerët ose punonjësit, por jo më shumë se 100 investitorë të jashtëm, që adresohen drejtpërdrejt tek emetuesi. Investitorët institucionalë janë fondet e pensioneve, shoqëritë e sigurimeve dhe personat juridikë që investojnë tituj vetëm nëpërmjet portofoleve të tyre të investimeve. Investitori i jashtëm është çdo individ ose person juridik, vendas apo i huaj, që nuk është aksioner apo punonjës i emetuesit dhe investitorit institucional. (Mustafari, 2019)

Statuti i shoqërisë duhet të hartohet dhe të depozitohet në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit, së bashku me dokumentet e tjera të kërkuara (Neni 1/2 dhe Neni 106, Neni 115. LIGJ Nr.9901, datë 14.4.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare"). Në shoqëritë tregtare, një kusht i domosdoshëm për t'u konsideruar subjekte të ligjshme është regjistrimi në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit (QKR). Neni 26/3 i ligjit për QKR parashikon se kërkesa për regjistrimin fillestar të shoqërive tregtare mund të bëhet nga ortakët e një shoqërie kolektive, ortakët e pakufizuar të një shoqërie komandite, administratorët e një Shoqërie me Përgjegjësi të Kufizuar (SHPK), anëtarët e këshillit të administrimit të një Shoqërie Aksionare (SHA), ose nga personi i autorizuar (Sipas nenit 26/3 të ligjit për QKB) Dokumentet për regjistrim renditen në nenin 283/3 të ligjit për QKR (Neni 283/3). Me hyrjen në fuqi të ligjit për QKR dhe ligjit të ri "Për tregtarët dhe Shoqëritë tregtare", procedurat e themelimit të një shoqërie tregtare janë thjeshtëzuar në aspektin kohor, formal duke ulur dhe koston e këtyre veprimeve. Akti i themelimit dhe statuti i shoqërisë janë dy akte që shprehin vullnetin e ortakëve/aksionerëve themelues për tu bashkuar në një sipërmarrje tregtare dhe përcaktojnë rregullat dhe funksionet e sipërmarrjes. Legjislacioni i

ri për themelimin dhe regjistrimin e shoqërive tregtare ka lënë si mundësi alternative mosparaqitjen në QKR të aktit të themelimit dhe statutit të shoqërisë për tre llojet e shoqërisë duke i zëvendësuar këto akte me aplikimin për regjistrim fillestar, të plotësuar me të gjitha të dhënat e detyrueshme sipas ligjit për QKR, në dokumentet e identifikimit të anëtarëve apo ortakëve që duhet të nënshkruajnë deklaratën e posaçme për njohjen, pranimin dhe zbatimin e dispozitave në fuqi, për organizimin dhe funksionimin e llojit të shoqërisë që do të regjistrohet. Megjithatë, ky lloj regjistrimi pa statut konsiderohet si rast i veçantë.

Statuti i çdo shoqërie tregtare duhet të përfshijë informacion të caktuar që identifikon emrin, formën ligjore dhe zyrën qendrore të shoqërisë. Shoqëritë aksionare me ofertë publike duhet të regjistrojnë të dhënat e identifikimit të themeluesve, projekt-statutin dhe të kryejnë njoftime paraprake në përputhje me ligjin. Themeluesit mbajnë përgjegjësi për veprimet e kryera deri në themelimin e shoqërisë, ndërsa pas themelimit, ata mbeten përgjegjës ndaj shoqërisë për veprimet e tyre të kryera gjatë procesit të themelimit (Neni 10/2 i ligjit për QKB).

Kapitali aksionar: Shoqëritë aksionare janë të detyruara të kenë një kapital aksionar minimal, ku shoqëritë aksionare me ofertë private nuk mund të kenë më pak se 2,000,000 lekë, ndërsa shoqëritë aksionare me ofertë publike nuk mund të kenë më pak se 10,000,000 lekë (Neni 107. LIGJ Nr.9901, datë 14.4.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”). Kapitali aksionar duhet të ndahet në aksione me vlerë të barabartë dhe aksionarët duhet të paguajnë të paktën 25% të vlerës nominale të aksioneve të tyre në momentin e nënshkrimit.

Mbledhjet e aksionarëve: Shoqëritë aksionare duhet të mbajnë mbledhje të përgjithshme vjetore të aksionarëve dhe sipas nevojës mund të thirren mbledhje të jashtëzakonshme. Aksionarët kanë të drejtë të votojnë për çështje të tilla si zgjedhja e bordit të Administratorëve, miratimi i pasqyrave financiare dhe shpërndarja e dividendëve.

Bordi i Administratorëve: Shoqëritë aksionare duhet të kenë një bord drejtues të përbërë nga të paktën tre anëtarë, të cilët zgjidhen nga aksionarët. Bordi i Administratorëve është përgjegjës për menaxhimin e përgjithshëm dhe drejtimin strategjik të kompanisë.

Auditimi: Shoqëritë aksionare duhet të caktojnë një auditues të jashtëm për të rishikuar dhe vërtetuar pasqyrat e tyre financiare. (Konomi, Kuadri ligjor për shoqëritë aksionare në Shqipëri., 2018)

Dhënia e informacioneve shpjeguese: Shoqëritë aksionare duhet të zbulojnë informacione të caktuara për publikun, duke përfshirë statutin e tyre, pasqyrat financiare vjetore dhe ndryshimet në kapitalin e tyre aksionar.

Shpërbërja: Shoqëritë aksionare mund të shpërndahen vullnetarisht ose me vendim gjykate dhe duhet të ndjekin disa procedura për mbylljen e punëve të tyre si dhe shpërndarjen e asetëve të caktuara.

2.1.1. Llojet e kontributeve

Sipas ligjit nr.9901, datë 14.4.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", ka disa lloje kontributesh që mund të bëhen në shoqërinë aksionare në Shqipëri (Ligji nr.9901, datë 14.4.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare") Aksionarët mund të japin kontributet e tyre në shoqëri në formën e para ose në të drejta me vlerë në para, por nuk lejohet të japin kontributet e tyre në formën e punës ose shërbimeve.

Kjo përfshin:

Kontributet në para: Aksionarët mund të kontribuojnë me para për kompaninë në këmbim të aksioneve. Shuma e kontributit në para duhet të jetë së paku 25% e vlerës nominale të aksioneve të nënshkruara. (Deloitte., 2021)

Kontributet në natyrë: Aksionarët mund të kontribuojnë gjithashtu me aktive të tjera përveç parave të gatshme, të tilla si pasuri të paluajtshme, pajisje ose të drejta të pronësisë intelektuale. Vlera e kontributit në natyrë duhet të përcaktohet nga një ekspert i pavarur dhe kontributi duhet të miratohet nga asambleja e përgjithshme e aksionarëve.

Kur aksionarët japin kontribute në natyrë, përpara regjistrimit të shoqërisë, një apo disa ekspertë të caktuar nga gjykata përkatëse (Neni 112. LIGJ Nr.9901, datë 14.4.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare") të licencuar sipas kriterëve ligjore dhe me kompetenca teknike të nevojshme, duhet të vlerësojnë këto kontribute dhe të përgatisin një raport të

detajuar që përshkruan kontributet në natyrë, metodat e vlerësimit të përdorura, dhe tregon nëse vlera e llogaritur i plotëson së paku vlerat nominale të aksionit dhe, kur aplikohet, primit më të lartë të emetimit të aksionit (Neni 113. LIGJ Nr.9901, datë 14.4.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”).

Vetëm shoqëritë ekzistuese të regjistruara për të paktën 2 vite kanë lejen të japin si kontribut në një shoqëri aksionare aktivet, kuotat ose aksionet e tyre, duke paraqitur pasqyrat financiare të dy viteve të fundit dhe dokumentet për vlerësimin e tyre. (Investimeve., 2021)

Përpara regjistrimit, raporti i vlerësimit dhe dokumentet e tjera duhet të paraqiten në Qendrën Kombëtare të Biznesit bashkë me aplikimin për regjistrim (Neni 106. LIGJ Nr.9901, datë 14.4.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”). Një vlerësim është i kërkuar edhe nëse shoqëria, brenda dy viteve pas themelimit, blen pasuri ose të drejta nga një prej themeluesve. Megjithatë, raporti i vlerësimit nuk është i nevojshëm kur shoqëria themelohet si rezultat i bashkimit ose ndarjes së shoqërive, në rastin e rritjes së kapitalit të realizuar në kuadër të bashkimit ose ndarjes, si dhe në rastin e një oferte për marrjen e kontrollit. (BankaBotërore., 2021)

Vlen të theksohet se ligji kërkon që të gjitha kontributet të bëhen në mirëbesim dhe në dobi të shoqërisë. Aksionarët që bëjnë deklaratat të rreme në lidhje me kontributet e tyre, janë përgjegjës për dëmet. Krahas llojeve të mësipërme të kontributeve, ligji përmes rezervës ligjore përcakton edhe krijimin e një fondi rezervë, i cili financohet nga një pjesë e fitimeve të shoqërisë. Ligji parashikon se shoqëritë aksionare duhet të krijojnë një fond rezervë të paktën 5% të fitimeve neto të tyre, derisa të arrijnë një nivel të caktuar të mbushjes së këtij fondi (tipikisht, 10% e kapitalit të regjistruar të shoqërisë), (Ligji nr. 9901, datë 14.04.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare"). Në praktikë, shoqëritë aksionare në Shqipëri shpesh financojnë fondin rezervë me një pjesë të fitimeve të tyre të realizuara në periudha të caktuara. Kjo është një mënyrë për të siguruar një rezervë financiare të brendshme për shoqërinë, që mund të përdoret për investime të ardhshme, përgjegjësi financiare ose rreziqe të papritura që mund të hasë shoqëria. Kjo masë ka për qëllim të forcojë stabilitetin financiar të shoqërive dhe të sigurojë një bazë më të qëndrueshme për aktivitetin e tyre në të ardhmen. Fondi rezervë synon gjithashtu të forcojë pozicionin financiar të kompanisë dhe mund të përdoret për të mbuluar humbjet ose për të investuar në projekte të reja. (GrupiiBankësBotërore., 2021)

Në përgjithësi, llojet e kontributeve të lejuara në shoqëritë aksionare në Shqipëri janë krijuar për të ofruar fleksibilitet dhe për të inkurajuar investimet në këto subjekte të rëndësishme biznesi. Duke i lejuar aksionarët të kontribuojnë me para, aktive, shërbime ose kërkesa, shoqëritë aksionare mund të kenë akses në një sërë burimesh dhe ekspertize, të cilat mund t'i ndihmojnë ata të rriten dhe të lulëzojnë në një treg konkurrues. (Konomi, Kuadri ligjor për shoqëritë aksionare në Shqipëri., 2018)

Shlyerja dhe kalimi i kontributeve përpara regjistrimit

Para regjistrimit të shoqërisë, aksionet e nënshkruara me kontribut në para duhet të shlyhen të paktën në një të katërtën e vlerës nominale të tyre, ndërsa aksionet e nënshkruara me kontribut në natyrë duhet të paguhen tërësisht para regjistrimit duke kaluar titullin e pronësisë së kontributit në natyrë në favor të shoqërisë. Themeluesit që nuk plotësojnë ose transferojnë kontributet e tyre brenda afateve të caktuara përgjigjen ndaj shoqërisë (Neni 113. LIGJ Nr.9901, datë 14.4.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”).

2.1.2. Llojet dhe kategoritë e aksioneve

Aksionet mund të jenë të zakonshme ose aksione me përparësi (Neni 116. LIGJ Nr.9901, datë 14.4.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”).

Aksionet në shoqëritë aksionare mund të jenë të zakonshme ose me përparësi, duke ofruar të drejta të ndryshme për zotëruesit e tyre (Neni 116/1. LIGJ Nr.9901, datë 14.4.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”). Aksionet e zakonshme japin të drejta në asamblenë e përgjithshme dhe përfitime nga fitimet dhe pasuritë e mbetura, ndërsa aksionet me përparësi ofrojnë përparësi në ndarjen e pasurive pas likuidimit (Po aty neni 116/2). Aksionet e një kategorie kanë të njëjtat të drejta dhe mund të fitohen ose transferohen përmes kontributit në kapital, shitblerjes, trashëgimisë, dhurimit ose nëpërmjet mënyrave të tjera të parashikuara ligjërisht (Po aty, Neni 117)

Të drejtat e aksioneve të fituara, siç u përmend më parë, nuk mund të zbatohen kundër asnjë personi ose shoqërie para se veprimi të regjistrohet në regjistrin e posaçëm të aksioneve që mbahet nga shoqëria. (Deloitte., 2021) Në rastet kur aksionet kalohen me kontratë, kushtet dhe koha e kalimit, duke përfshirë kohën e pagesës së çmimit, rregullohen

nga kontrata. Kontrata duhet të jetë në formë të shkruar dhe të bëhet me akt publik. Këto janë kushtet për vlefshmërinë ose regjistrimin e kontratës (Neni 117/2. LIGJ Nr.9901, datë 14.4.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”).

Procedura e regjistrimit të aksioneve përfshin:

1. Shoqëritë aksionare (Neni 119/1. LIGJ Nr.9901, datë 14.4.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”) duhet të mbajnë një regjistër të veçantë ku regjistrohen të dhënat e zotëruesve të aksioneve, si emri, vlera nominale, adresa dhe data e regjistrimit. (AgjenciaShqiptareeZhvillimittëInvestimeve., 2021)
2. Personat e regjistruar konsiderohen zyrtarisht si aksionarë me të drejta të plota ndaj shoqërisë dhe të tretëve (Neni 119/2).
3. Administratorët janë përgjegjës për mbajtjen dhe sigurimin e aksesit në regjistrin e aksioneve dhe informacioni i regjistrimit duhet të publikohet në faqen e internetit të shoqërisë (aty Neni 119/3).

Ligji dhe statuti mund të caktojnë kushte për kalimin e aksioneve, duke përfshirë miratimin nga organet drejtuese dhe/ose të drejtën e parablerjes nga aksionarët ekzistues (Neni 120).

Një aksion i shoqërisë mund të jepet në pronësi të disa personave, të cilët mund të përfaqësohen nga një përfaqësues i përbashkët për të ushtruar të drejtat e tyre si aksionarë. (Neni 121/1). Personat që kanë në mënyrë të përbashkët një aksion (Neni 121/2) janë përgjegjës solidarë për detyrimet e tij, ndërsa vendimet lidhur me të drejtat dhe detyrimet e aksionit duhet të ndahen në mënyrë të barabartë ose jo (Neni 121/3). Veprimet e shoqërisë ndaj një aksioni që i takon disa personave kanë pasoja ndaj të gjithë zotëruesve, edhe nëse veprimi drejtohet vetëm ndaj njëri prej tyre (Neni 121/4).

Të drejtat e votës në shoqëri janë si vijon:

1. Të gjithë zotëruesit e aksioneve të zakonshme kanë të drejta vote në asamblenë e përgjithshme në raport me pjesën e kapitalit që përfaqëson secili prej tyre.
2. Aksionet me përparësi nuk kanë të drejtë vote dhe nuk mund të përfaqësojnë më shumë se 49% të kapitalit të regjistruar të shoqërisë.
3. Kemi ndalimin e emetimit të aksioneve që i japin zotëruesve të tyre më shumë të drejta vote se sa pjesa e kapitalit që ato përfaqësojnë.

2.3. Marrëdhëniet midis shoqërisë dhe aksionerëve

Aksionarët shlyejnë kontributin e tyre duke paguar vlerën nominale të aksionit ose çmimin më të lartë të emetimit në llogarinë e shoqërisë, duke u përpjekur të përputhen me specifikat e kontributit ose duke ndjekur mënyrat e përcaktuara në statut (Neni 123). Sipas Ligjit Nr. 9901, datë 14.04.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare" në Shqipëri, çmimi më i lartë i emetimit është vlera nominale e aksionit ose çmimi i caktuar në aktin e themelimit të shoqërisë, në rast se ai është më i lartë se vlera nominale. Në rast se shoqëria vendos që të caktojë një çmim më të lartë se vlera nominale e aksionit në aktin e themelimit, atëherë ky çmim i caktuar do të jetë çmimi më i lartë i emetimit (Sipas Ligjit Nr. 9901, datë 14.04.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare"). Kjo do të thotë se kontributi nga ana e aksionarëve për blerjen e aksioneve të shoqërisë do të bëhet duke shlyer vlerën nominale të aksionit ose çmimin më të lartë të emetimit në rast se ai është më i lartë se vlera nominale. Për të përcaktuar çmimin e emetimit, shoqëria duhet të kryejë një analizë të mjaftueshme dhe të përmbushë kriteret dhe procedurat e caktuara nga ligji dhe organet kompetente, duke garantuar transparencën dhe rregullsinë në procesin e emetimit të aksioneve.

Pasojat e vonesës në shlyerjen e kontributit janë (Neni 124):

1. Aksionari detyrohet të paguajë një kamatëvonesë prej 4% në vit të shumës së pashlyer të kontributit në para, dhe shoqëria mund të kërkojë dëmshpërblim shtesë për dëmet e tjera të shkaktuara nga vonesa (Neni 124/1).
2. Nëse aksionari nuk shlyen kontributin brenda afatit të caktuar, ai humbet të drejtën për të marrë pjesë në asamblenë e përgjithshme dhe të përfitojë dividendë, ndërsa aksionet e tij nuk merren parasysh në llogaritjen e kuorumit (neni 124/2).
3. Nëse kontributi nuk shlyhet brenda 3 muajve pas skadimit të afatit, shoqëria mund të zvogëlojë kapitalin dhe të anulojë aksionin (neni 124/3).

Shoqëria nuk ka leje të falë detyrimin e aksionarëve për të shlyer kontributet në para ose në natyrë, si dhe detyrime tjera që lidhen me mosrealizimin e detyrimit për shlyerjen ose kalimin e kontributeve (Neni 125/1). Aksionarët nuk kanë të drejtë të kompensojnë të drejtat e tyre ndaj shoqërisë me detyrimin për shlyerjen ose kalimin e kontributeve, dhe

nuk kanë të drejtë të japin një kontribut të ngarkuar me barrë shoqërisë (Neni 125/2). Nëse shoqëria vendos të çlirojë aksionarët nga detyrimi për të shlyer kontributet në para ose në natyrë, ajo mund ta bëjë vetëm duke zvogëluar kapitalin e zakonshëm të shoqërisë në përpjesëtim me vlerën që kapitali zvogëlohet. Shoqëria mund të lirojë aksionarët nga këto detyrime edhe duke anuluar aksionet e tyre (Neni 125/3)

Ndalimi i rimbursimit të kontributeve, përveç rasteve të përcaktuara nga ligji, është i detyrueshëm për shoqëritë (Neni 126). Shoqëritë duhet të kalojnë një pjesë të fitimit të tyre në rezervën ligjore, e cila duhet të jetë së paku 5 për qind e fitimit pas tatimit të vitit financiar paraardhës, deri sa të arrihet një shumë prej 10 për qind të kapitalit të regjistruar të shoqërisë ose një shumë më të lartë, siç është përcaktuar në statut. Statuti mund të parashikojë edhe krijimin e rezervave të tjera nga fitimet vjetore. Dividendët duhet të llogariten pas kalimit të rezervës ligjore (Neni 127).

Dividendi është pjesa e fitimeve vjetore të shoqërisë që i takon çdo aksionari dhe është vendosur nga asambleja e përgjithshme (Neni 128/1). Llogaritja e fitimeve bëhet në përputhje me parimet e ligjit për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare (neni 128/2). Shpërndarja e dividendit ndahet në bazë të vlerës së kapitalit të regjistruar që aksionet përfaqësojnë për secilin aksionar (Neni 128/3). Asambleja ka të drejtë të vendosë të mos shpërndajë dividendë ose të mos paguajë fitimin vjetor për kategori të veçanta të aksionarëve, por këto shuma mund të përdoren për qëllime të tjera. Të drejtat e aksionarëve mund të ndryshohen me vendim të marrë me tre të katërta të votave, në përputhje me statutin (Neni 128/4). Aksionarët janë të detyruar t'i kthejnë shoqërisë shumat e marra në kundërshtim me ligjin, përfshirë dividendët. Kërkesa për kthimin e fitimeve duhet të bëhet brenda 3 viteve nga data e pagesës së parregullt (Neni 129). Shpërblimi i përfituar nga aksionari, përveç kontributit në kapital, nuk mund të jetë më i lartë se vlera normale e tregut për veprime ekonomike të ngjashme (Neni 130).

Në situatat kur aksionari i jep një huadhënie shoqërisë në kushte më pak të favorshme se ato të tregut dhe shoqëria është në vështirësi financiare, aksionari nuk ka të drejtë të kërkojë kthimin e huasë, pasi ky veprim do të zvogëlojë kapitalin e tij nën nivelin minimal (Neni 131). Nëse huaja vjen nga një person i tretë dhe aksionari jep garanci për rikthimin e saj, personi i tretë mund të kërkojë vetëm rikthimin e shumës që nuk mund të kryhet me garancinë e aksionarit, në rast se shoqëria është në vështirësi financiare (Neni 131/2). Nëse shoqëria i ka shlyer kredinë aksionarit në një periudhë njëvjeçare para fillimit të procesit të falimentimit, atëherë aksionari që ka marrë shlyerjen e kredisës ose ka dhënë garanci duhet

të kthejë shoqërisë shumën e paguar si kredi (Neni 131/3). Aksionari është përgjegjës deri në vlerën e garancisë në momentin e shlyerjes së kredisë. Megjithatë, aksionari nuk është përgjegjës për këto shuma kur kolaterali i dhënë si garanci është transferuar shoqërisë për shlyerjen e kredisës (Neni 132).

2.4. Organet e shoqërisë aksionare sipas ligjit

Organet kryesore të shoqërive aksionare janë asambleja e përgjithshme, këshilli i administrimit, këshilli mbikëqyrës dhe administratorët (Neni 134).

Asambleja e përgjithshme merr vendime të rëndësishme për politikën tregtare, ndryshime në statut, emërimet dhe shkarkimet e anëtarëve të këshillit të administrimit dhe të këshillit mbikëqyrës, miratimin e pasqyrave financiare vjetore, shpërndarjen e fitimeve, zmadhimin ose zvogëlimin e kapitalit të regjistruar, pjesëtimin e aksioneve, ndryshimet në të drejtat e aksionarëve, përfaqësimin e shoqërisë në gjykimet ndaj organeve të administrimit, riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë, si dhe çështje të tjera të rregulluara në ligj ose statut (Neni 135/2).

Këshilli i administrimit ka përgjegjësi mbi drejtimin e përditshëm dhe menaxhimin e shoqërisë, ndërsa këshilli mbikëqyrës kryen mbikëqyrjen e veprimtarisë së këshillit të administrimit. Administratorët mund të caktohen dhe shkarkohen nga asambleja e përgjithshme ose nga këshilli mbikëqyrës, në përputhje me statutin (Neni 135/3). Shoqëritë aksionare janë të detyruara të përfshijnë në raportin e ecurisë së veprimtarisë dhe pasqyrat financiare vjetore një dokument shpjegues që trajton rregullat e miradministrimit dhe praktikën e shoqërisë. Ky dokument duhet të përmbajë profilin e administratorëve dhe të anëtarëve të këshillave, duke shpjeguar kualifikimet e tyre për detyrat që i janë caktuar nga shoqëria. Deklarata e miradministrimit duhet të jetë e disponueshme në faqen e internetit të shoqërisë.

Nëse shoqëria aksionare është zotëruar nga një aksionar i vetëm, të drejtat dhe detyrimet e asamblesë së përgjithshme ushtrohen nga ky aksionar. Vendimet e marrë nga aksionari i vetëm duhet të regjistrohen në një regjistër të vendimeve që nuk mund të ndryshohen ose fshihen. Këto vendime përfshijnë miratimin e pasqyrave financiare vjetore, shpërndarjen e

fitimeve, zmadhimin ose zvogëlimin e kapitalit, vendimet për investime, riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë (Neni 135/4).

Vendimet që nuk janë regjistruar në regjistrin e vendimeve janë të pavlefshme në mënyrë absolute. Shoqëria nuk ka të drejtë të mohojë pavlefshmërinë për personin e tretë që ka fituar të drejta në mirëbesim, përveç nëse shoqëria mund të dëshmojë se personi i tretë ka qenë i vetëdijshëm për pavlefshmërinë ose në rastet kur, në bazë të rrethanave të qarta, personi i tretë nuk mund të kishte pasur dijeni për të (Neni 135/4).

Mënyrat e thirrjes së mbledhjes së asamblesë së përgjithshme të një shoqërie aksionare parashikohen në ligj (Neni 137). Ato përfshijnë:

1. Asambleja e përgjithshme thirret me një njoftim me shkresë ose postë elektronike, dhe duhet të dërgohet të gjithë aksionarëve jo më vonë se 21 ditë para datës së mbledhjes (Neni 137/1).
2. Njoftimi duhet të përmbajë emrin e shoqërisë, selinë e regjistruar, vendin dhe orën e mbledhjes, si dhe procedurat e nevojshme për të marrë pjesë dhe votuar në asamble. Njoftimi duhet të përmbajë informacion për vendin dhe mënyrat e marrjes së dokumenteve dhe projektvendimeve, si dhe adresën e faqes së internetit të shoqërisë (Neni 137/2).
3. 21 ditë përpara datës së mbledhjes, shoqëria duhet të vendosë në dispozicion të aksionarëve në faqen e saj në internet informacionin për numrin total të aksioneve dhe të drejtave të votës, si dhe dokumentet që do të diskutohen në asamble (Neni 137/3).
4. Në rastin kur shoqëria ka shumë aksionarë, thirrja e mbledhjes mund të njoftohet edhe në një gazetë të përditshme me shpërndarje në të gjithë vendin (Neni 137/4).

Këto udhëzime janë të rëndësishme për të siguruar që të gjithë aksionarët kanë mundësinë të marrin pjesë në asamble dhe të kenë informacionin e nevojshëm për të votuar me njohuri të plotë. Nëse shoqëria nuk ndjek këto udhëzime, mund të përballen me sfida legale nga aksionarët e tjerë.

Rendi i ditës është një dokument i rëndësishëm që përmban vendimet dhe çështjet që do të diskutohen në asamblenë e përgjithshme të një shoqërie. Ai duhet të përmbajë të gjitha propozimet dhe ndryshimet e statutit nëse janë në rend të ditës. Administratorët janë të detyruar të përgjigjen në shkrim për çdo kërkesë për sqarim që i bëhet në lidhje me rendin

e ditës. Në rast se asambleja e përgjithshme nuk është thirrur sipas formaliteteve të ligjit, ajo mund të marrë vendime vetëm nëse të gjithë aksionarët janë të pranishëm dhe shprehen dakord për të marrë vendime, pavarësisht parregullsisë (Neni 138).

Aksionarët që përfaqësojnë të paktën 5% të kapitalit të shoqërisë mund të marrin pjesë në asamblenë e përgjithshme dhe të kërkojnë përfshirjen e çështjeve të caktuara në rendin e ditës. Nëse kërkesa nuk është pranuar, këta ortakë kanë të drejtë të thërrasin asamblenë e përgjithshme e të vendosin çështje në rendin e ditës. Në rast se asambleja nuk thirret ose kërkesa e tyre nuk përfshihet në rendin e ditës, aksionarët kanë të drejtë të ngrejë padi në gjykatë për të deklaruar shkeljen e detyrimit të besnikërisë ose të kërkojnë blerjen e aksioneve të tyre nga shoqëria.

Në rastet kur rendi i ditës ndryshohet dhe thirrja u është njoftuar ortakëve, administratorët duhet t'i njoftojnë përsëri në të njëjtat mënyra me të cilat është kryer njoftimi i pare (Neni 139).

2.5. Përfaqësimi në asamble në shoqëritë aksionare

Askionari nuk mund të ketë përfaqësim në asamblenë e përgjithshme (Neni 140/1).

Në paragrafin e dytë, theksohet se administratorët dhe anëtarët e këshillit të administrimit apo të këshillit mbikëqyrës nuk mund të veprojnë si përfaqësues të aksionarëve në asamblenë e përgjithshme. Kjo do të thotë se ata nuk mund të marrin pjesë në emër të aksionarëve në këto mbledhje (Neni 140/2).

Paragrafi i tretë flet për autorizimin që jepet për një mbledhje të asamblesë së përgjithshme, ku përfaqësuesi i autorizuar është i detyruar të deklarojë çdo fakt apo rrethanë që mund të ndikojë në vendimmarrjen e përfaqësuesit për interesa të tjerë të ndryshëm nga ata të aksionarit përfaqësuar (Neni 140/3).

Në pjesën e nenit 144, flitet për pjesëmarrjen në mbledhjen e asamblesë së përgjithshme. Statuti ose asambleja e përgjithshme ka kompetencën të vendosë rregulla për procedurat e mbajtjes dhe pjesëmarrjes në asamble. Këto rregulla duhet të aprovohen nga asambleja e përgjithshme me një shumicë të paktën tre të katërtat e kapitalit të përfaqësuar në mbledhje (Neni 141/4).

Paragrafi i dytë thotë se nëse nuk është parashikuar ndryshe në statut, asambleja e përgjithshme duhet të caktojë një kryetar (Neni 141/2).

Paragrafi i tretë flet për listën e aksionarëve të pranishëm dhe të përfaqësuesve të tyre, e cila përgatitet gjatë mbledhjes së asamblesë së përgjithshme. Ky regjistër përmban të dhënat personale si emrat dhe adresat e çdo individ, së bashku me informacionin e numrit të aksioneve të tyre, numrin e votave që këto aksione paraqesin, vlerën nominale të aksioneve, si dhe llojin ose kategorinë e aksioneve të cilat secili pjesëmarrës posedon. Ky regjistër është i qasshëm për aksionarët dhe përfaqësuesit e tyre, dhe ata janë përgjegjës për nënshkrimin e tij (Neni 141/3).

Paragrafi i katërt thotë se aksionarët mund të vendosin që çdo vendim, që ata kanë të drejtë nëpërmjet një marrëveshjeje unanime me shkrim (Neni 141/4).

Gjithashtu në ligj parashikohet edhe mundësia për pjesëmarrje me mjete komunikimi elektronike (Neni 142) përfshirë mjete të ndryshme, me kusht që të garantohet identifikimi i ortakëve (Neni 142/1).

Në ligj gjithashtu parashikohen disa rregulla dhe procedura për mbledhjen e asamblesë së përgjithshme të një shoqërie dhe kuorumin (Nenet 143-144) Këtu janë pika kryesore:

1. Të gjitha vendimet e asamblesë së përgjithshme duhet të regjistrohen në procesverbal dhe të ruhen nga administratorët (Neni 143/1).
2. Procesverbali duhet të regjistrojë informacionet e mëposhtme: datën dhe vendin e mbledhjes, rendin e ditës, emrat e kryetarit dhe sekretarit të procesverbalit, rezultatet e votimit, vendimet e marra, deklaratën e kryetarit rreth vendimmarrjes, si dhe mendimet ose kundërshtimet e shprehura nga aksionarët (Neni 143/2).
3. Lista e pjesëmarrësve dhe dokumentacioni i thirrjes së asamblesë së përgjithshme duhet të bashkëlidhen me procesverbalin (Neni 143/3).
4. Procesverbali dhe lista e pjesëmarrësve duhet të nënshkruhen nga kryetari dhe nga mbajtësi i procesverbalit (Neni 143/4)
5. Procesverbali duhet të publikohet në faqen e internetit të shoqërisë jo më vonë se 15 ditë nga data e mbledhjes (Neni 143/5).
6. Nëse asambleja duhet të marrë vendime me shumicë të zakonshme, aksionarët që zotërojnë më shumë se 30% të aksioneve me të drejtë vote duhet të jenë të pranishëm ose të përfaqësuar në votim. Nëse vendimet kërkojnë shumicë të kualifikuar, aksionarët që zotërojnë më shumë se gjysmën e numrit total të

aksioneve me të drejtë vote duhet të marrin pjesë në votim personalisht ose votojnë me shkresë apo me mjete elektronike (Neni 144/1).

7. Nëse kuorumi nuk arrin të plotësohet, asambleja mund të mbledhet përsëri jo më vonë se 30 ditë me të njëjtin rend dite (Neni 144/2).

Marrja e vendimeve

1. Përveç rasteve kur statuti parashikon një shumicë më të lartë, asambleja e përgjithshme vendos me tre të katërtat e votave të aksionarëve të pranishëm në votim për ndryshimin e statutit, rritjen ose uljen e kapitalit të regjistruar, shpërndarjen e fitimeve, riorganizimin dhe shfuqizimin e shoqërisë.
2. Përveç rasteve kur ligji ose statuti parashikojnë ndryshe, asambleja e përgjithshme merr vendime për çështje të tjera me shumicën e votave të aksionarëve të pranishëm.
3. Përveç rasteve kur ligji parashikon ndryshe, vlefshmëria e vendimeve që imponojnë detyrime shtesë mbi aksionarët ose kufizojnë të drejtat e tyre, të parashikuara në këtë ligj, statut ose vendime të tjera, kushtëzohet nga miratimi i aksionarit përkatës.

2.6. E drejta e votës dhe mënyra e votimit në shoqërinë aksionare sipas legjilasionit shqiptar

1. Mënyra e votimit

Ligji dhe statuti mund të parashikojnë mënyra të ndryshme të votimit në asamblenë e përgjithshme të shoqërisë aksionare. Nëse nuk parashikohet ndryshe, vendimet merren me votim të hapur, që do të thotë se secili aksionar voton publikisht (Neni 146/1).

Për raste të veçanta, si emërimi dhe shkarkimi i anëtarëve të këshillit të administrimit ose të këshillit mbikëqyrës, asambleja e përgjithshme vendos me votim të fshehtë. Ky lloj votimi kërkohet nga aksionarët që zotërojnë një numër aksionesh të barabartë ose më të lartë se 5 për qind të kapitalit të regjistruar të shoqërisë (Neni 146/2).

2. E drejta e votës

Secili aksion mbart të drejtën e një vote, pavarësisht nga sasia e aksioneve që ai zotëron. Kjo do të thotë se secili aksionar ka të drejtën e barabartë të votës në asamblenë e përgjithshme të shoqërisë (Neni 147).

3. Përfshirja nga votimi

Në disa raste të veçanta, aksionari nuk mund të ushtrojë të drejtën e votës. Kjo ndodh kur asambleja e përgjithshme duhet të marrë vendime për: (a) vlerësimin e veprimtarisë së tij; (b) faljen e ndonjë detyrimi që i takon personalisht; (c) ngritjen e një padie ndaj tij nga shoqëria; (ç) dhënien ose mosdhënien e përfitimeve të reja. Në rastet kur aksionari përfaqësohet me autorizim, kufizimi i votës zbatohet edhe për personin e autorizuar. Kjo do të thotë se aksionari nuk mund të delegojë të drejtën e votës për raste të veçanta, ku ai është i përfshirë në mënyrë të drejtpërdrejtë.

4. Aksionet me përparësi, pa të drejtë vote

Aksionet me përparësi, pa të drejtë vote, janë një lloj aksionesh në kompani që ofrojnë përfitime financiare, por nuk japin të drejtën e votës në takime të aksionarëve. Kjo do të thotë se personi që posedon këto aksione nuk ka të drejtën të votojë për vendimet e ndryshme të kompanisë, siç mund të bëjnë personat që kanë aksione të zakonshme. Këto aksione mund të jenë një opsion i mirë për investitorët që duan të marrin pjesë në fitimet e kompanisë, por nuk kanë interes të drejtpërdrejtë në menaxhimin e saj (neni 149).

2.7. Administratori dhe këshilli mbikqyrës në sistemin me një nivel

Në varësi të statutit, është përcaktuar nëse shoqëria aksionare do të ketë një nivel administrimi ose dy nivele administrimi. Në krahasim mes dy sistemeve të administrimit, vërehet:

- Sistemi i administrimit me një nivel parashikon që të drejtat e administrimit të jenë të përqëndruara në një organ siç është këshilli i administrimit.
- Sistemi i administrimit me dy nivele përfshin shpërndarjen e të drejtave të administrimit midis dy organeve, konkretisht midis këshillit mbikqyrës dhe administratorëve.

Këshilli i administrimit ka këto të drejta dhe përgjegjësi (neni 154):

- Jep direktiva për zbatimin e politikave tregtare të shoqërisë nga administratorët.
- Kontrollon dhe mbikëqyr zbatimin e politikave tregtare të shoqërisë nga administratorët.
- Përgatit vendime të nevojshme për interesat e shoqërisë dhe i rekomandon asamblesë së përgjithshme për miratim.
- Thërret mbledhjen e asamblesë së përgjithshme kur vlerësohet e nevojshme për interesat e shoqërisë.
- Siguron respektimin e ligjit dhe standardet e kontabilitetit nga shoqëria.
- Shqyrton dhe kontrollon librat kontabël, dokumentet dhe aktivet e shoqërisë.
- Siguron që pasqyrat financiare vjetore, raportet e ecurisë së veprimtarisë dhe detyrimet e tjera të raportimit të kryhen me saktësi nga administratorët.
- Siguron që auditimi i librave dhe regjistrimeve kontabël kryhet të paktën një herë në vit nga një ekspert kontabël i autorizuar dhe raporti i auditimit drejtohet asamblesë së përgjithshme.
- Emëron dhe shkarkon administratorët dhe ndan kompetencat ndërmjet tyre.
- Përcakton shpërblimin e administratorëve.
- Miraton marrjen përsipër të detyrimeve me vlerë më të lartë se 5% të aseteve të shoqërisë.
- Kryen veprime të tjera të përcaktuara në ligj dhe në statut.

Këshilli i administrimit përbëhet nga të paktën tre anëtarë dhe të paktën 21 anëtarë, të zgjedhur nga asambleja e përgjithshme e shoqërisë tregtare. Anëtarët duhet të jenë të pavarur dhe të ndryshëm nga administratorët e shoqërisë. Aksionarët që zotërojnë së bashku të paktën 5% të kapitalit të regjistruar kanë të drejtën të emërojnë një anëtar të këshillit të administrimit me një vendim të posaçëm. Anëtarët e zgjedhur në këtë mënyrë nuk mund ta rrisin numrin e anëtarëve të këshillit të administrimit mbi 21. Anëtarët e pavarur të këshillit të administrimit janë ata që nuk kanë konflikte interesi (Neni 155).

Disa kufizime vlejné për zgjedhjen e anëtarëve të këshillit të administrimit. Nuk lejohet që një individ të zgjidhet si anëtar i këshillit të administrimit nëse ai është tashmë anëtar i këshillit të administrimit ose të këshillit mbikëqyrës në dy shoqëri të tjera, është administrator i një shoqërie mëmë ose të një shoqërie të kontrolluar nga shoqëria, ose është administrator i një shoqërie tjetër, e cila ka si administrator ose anëtar të këshillit të administrimit një anëtar të këshillit të administrimit apo të këshillit mbikëqyrës të shoqërisë së parë. Një emërim në kundërshtim me këto kufizime është i pavlefshëm (Neni 156).

Këshilli i administrimit ka përgjegjësinë për emërimin e administratorëve të shoqërisë, që mund të jenë një ose më shumë persona fizikë. Statuti përcakton kohën e emërimit, e cila nuk mund të tejkalohet tre vjet. Anëtarët e këshillit të administrimit mund të mbajnë detyrën e administratorit vetëm nëse shumica e anëtarëve të këshillit të administrimit janë anëtarë të pavarur. Emërimi i administratorëve hyn në fuqi në datën e caktuar në aktin e emërimit (Neni 157).

Administratorët janë të detyruar dhe kanë të drejtë që të kryejnë të gjitha veprimet e administrimit të aktiviteteve tregtare të shoqërisë, si dhe të përfaqësojnë shoqërinë tregtare. Ata gjithashtu duhet të kujdesen për mbajtjen e dokumenteve dhe të librave kontabël të shoqërisë, të përgatisin dhe të nënshkruajnë bilancin vjetor, bilancin e konsoliduar dhe raportin e ecurisë së veprimtarisë. Këto dokumente duhet t'i paraqesin këshillit të administrimit për miratim, së bashku me propozimet për shpërndarjen e fitimeve, që pastaj duhet të paraqiten për miratim në asamblenë e përgjithshme (Neni 158/2/3).

Një tjetër detyrë përfshin krijimin e një sistemi monitorimi dhe njoftimi të hershëm për rrethanat që kërcënojnë ekzistencën e shoqërisë, të kryejnë regjistrimet e publikimet e detyrueshme të të dhënave të shoqërisë dhe të raportojnë përpara këshillit të administrimit për zbatimin e politikave tregtare dhe për veprimtarinë e shoqërisë. Përveç kësaj, ata kanë detyra të tjera të përcaktuara nga ligji dhe statute (Neni 158/4).

Nëse shoqëria ka disa administratorë, ata duhet të bashkëadministrojnë shoqërinë, përveç nëse statuti ose rregulloret parashikojnë ndryshe, dhe këshilli i administrimit ka të drejtën të shkarkojë administratorët në çdo kohë, ndërsa paditë rreth shpërblimit të anëtarit rregullohen sipas dispozitave ligjore aktuale. Një administrator i cili nuk është anëtar i këshillit të administrimit ka të drejtë të largohet nga detyra duke njoftuar këshillin e administrimit (Neni 158/5/6/7).

Shoqëritë tregtare kanë mundësi të autorizojnë një grup të caktuar prej administratorëve të tyre për të kryer veprime të përcaktuara, ndërsa njoftimet që u drejtohen secilit prej administratorëve janë të vlefshme dhe obliguese për shoqërinë (neni 159/2). Anëtarët e këshillit të administrimit mund të marrin pagë bazë dhe shpërblime shtesë, dhe shpërblimet individuale përcaktohen nga këshilli i administrimit në përputhje me ndarjen e detyrave të tyre. Anëtarët e këshillit të administrimit dhe administratorët janë solidarisht përgjegjës për saktësinë e të gjitha pasqyrave financiare, publikimet e detyrueshme dhe informacionet kyçe të aktivitetit të shoqërisë.

Vendimet e këshillit të administrimit vlerësohen të vlefshme nëse në procesin e vendimmarrjeve janë të pranishëm më shumë se një e dyta e anëtarëve dhe merren me shumicën e votave të anëtarëve të pranishëm (Neni 160). Administratorët dhe anëtarët e këshillit të administrimit kanë detyrimin e besnikërisë dhe përgjegjësinë për të kryer detyrat e tyre në mirëbesim e në interesin më të mirë të shoqërisë, si dhe për të ushtruar kompetencat e tyre vetëm për arritjen e qëllimeve të përcaktuara në statut (Neni 159/2)

2.8. Administratori dhe këshilli mbikëqyrës në sistemin me dy nivele

Organet kryesore mbi të cilat funksionon një shoqëri aksionare janë :

- Asambleja e Përgjithshme
- Këshilli i Administrimit
- Këshilli Mbikëqyrës

Në sistemin e administrimit me dy nivele, administratorët kanë detyrën e drejtimit të shoqërisë dhe marrjen e vendimeve për zbatimin e politikave tregtare, ndërsa këshilli mbikëqyrës, si organi mbikëqyrës, ka përgjegjësinë për të monitoruar zbatimin e këtyre politikave dhe për t'u siguruar se ato përputhen me ligjin dhe statutin e shoqërisë (Neni 166). Parashikimet ligjore që rregullojnë marrëdhënien midis këshillit të administrimit dhe administratorëve në sistemin me një nivel gjithashtu aplikohen edhe në marrëdhëniet midis administratorëve dhe anëtarëve të këshillit mbikëqyrës. Këshilli mbikëqyrës ka detyrat e kontrollit dhe mbikëqyrjes së politikave tregtare të shoqërisë, duke përfshirë: kontrollin e zbatimit e politikave nga administratorët, përgatitjen e rekomandimeve për vendime të nevojshme për asamblenë e përgjithshme, thirrjen e mbledhjeve të asamblesë së

përgjithshme, sigurimin e respektimit të ligjit dhe standardeve kontabile, shqyrtimin e librit kontabël, dokumenteve dhe asetëve të shoqërisë, sigurimin e saktësisë në pasqyrat financiare dhe raportet e ecurisë, dhe paraqitjen e dokumenteve për miratim në asamblenë e përgjithshme, së bashku me një raport të këshillit të administrimit dhe një përshkrim të mbikëqyrjes së menaxhimit gjatë vitit financiar (neni 167).

Administratorët mund të emërohen dhe shkarkohen në bazë të statutit nga asambleja e përgjithshme ose këshilli mbikëqyrës, në përputhje me parashikimet ligjore. Në sistemin me dy nivele, administratorët kryejnë të njëjtat funksione si në sistemin me një nivel, shtuar me pjesën e funksioneve të këshillit të administrimit. Miratimi i veprimeve të administratorëve nga këshilli mbikëqyrës është i nevojshëm vetëm nëse parashikohet në statut, përveç rasteve të përcaktuara në ligj. Këshilli mbikëqyrës nuk mund të zgjedhë administratorë të shoqërisë ose të shoqërive të tjera të të njëjtit grup, apo personat e lidhur me ta. Parashikimet ligjore për këshillin e administrimit në sistemin me një nivel zbatohen edhe për numrin, emërimin, përbërjen dhe shkarkimin e anëtarëve të këshillit mbikëqyrës, me disa përjashtime si: anëtarët e këshillit duhet të jenë të pavarur dhe statuti mund të lejojë zgjedhjen dhe shkarkimin e disa anëtarëve nga punëmarrësit e shoqërisë.

Parashikimet ligjore për këshillin e administrimit në sistemin me një nivel janë të aplikueshme edhe për shpërblimin, organizimin e brendshëm dhe marrjen e vendimeve nga këshilli mbikëqyrës. Anëtarët e këshillit mbikëqyrës janë përgjegjës për dëmet e shkaktuara nga mospërmbushja e detyrave të tyre dhe për shkeljen e standardeve të kujdesit. Ata janë gjithashtu përgjegjës për shkeljet e administratorëve, kur ata nuk njoftojnë asamblenë e përgjithshme edhe pse kanë dijeni për to, ose kur nuk kanë zbuluar shkeljen dhe nuk kanë ndërmarrë njoftimet dhe masat e nevojshme sipas ligjit (Neni 167).

Hetimi i posaçëm

Përveç informacioneve të sipërpërmendura, që kanë një natyrë të përgjithshme, aksionarët kanë të drejtë të angazhohen për të ushtruar hetim për çështje të posaçme. (Neni 150)

Për të realizuar një nismë të tillë, aksionarët duhet të grupohen për të përfaqësuar të paktën 5% të vlerës së kapitalit të regjistruar të shoqërisë, nëse statuti nuk parashikon një prag më të ulët. Objekt hetimi mund të jenë çështje të një spektri të gjerë, duke filluar nga veprimet e parregullta në themelimin e shoqërisë deri tek çështje që lidhen me ushtrimin e veprimtarisë tregtare të shoqërisë apo funksionimin e organeve administruese të saj. Kërkesa për fillimin e hetimit i drejtohet asamblesë së aksionarëve, e cila duhet të marrë

vendim për këtë dhe, në rast pranimit, të caktojë një ekspert të fushës për të kryer hetimin. Në rast se asambleja e refuzon këtë kërkesë apo nuk merr vendim Brenda 60 ditëve nga dita e parashtrimit të kërkesës, aksionarët mund t'i drejtohen gjykatës Brenda 30 ditëve nga dita që konsiderohet si data e refuzimit. Aksionarët mund t'i drejtohen gjykatës edhe në rastin kur nuk kanë rënë dakord me ekspertin që ka caktuar asambleja e aksionarëve për shkak të dyshimeve të bazuara se eksperti mund të mos e realizojë siç duhet hetimin e posaçëm. Përveç kushtit të pragut të përfaqësimit që duhet të përmbushin aksionarët që kërkojnë hetim të posaçëm, kjo procedure kushtëzohet edhe nga një afat parashkrimi: kërkesa për hetim të posaçëm duhet të ngrihet Brenda 3 vitesh nga data e veprimit të parregullt.

Likuidimi i shoqërisë aksionare

Në rastet kur shoqëria është prishur për shkak të humbjeve dhe kalimit në gjëndjen e paaftësisë paguese, prishja pasohet nga hapja e procedurave të falimentimit. Në të gjitha rastet e tjera, prishja e shoqërisë aksionare ka si pasojë hapjen e procedurave të falimentimit. Dispozitat mbi likuidimin, konkretisht nenet 190-205 të ligjit “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, vlejnë për të katër format e shoqërive tregtare. Këto dispozita parashikojnë dy procedura likuidimi: *procedurën e zakonshme dhe procedurën e thjeshtuar*.

Likuidimi është një operacion tregtar po aq i rëndësishëm sa themelimi i shoqërisë. (Malltezi, E drejta shqiptare e shoqërive tregtare, 2011) Të tretët duhet të njoftohen për kalimin e shoqërisë në likuidim në të njëjtën mënyrë siç njoftohen për formimin e saj. Në të dyja rastet duhet bërë publikimi në QKR. Likuidimi, fuqia ligjore dhe efektet e këtij procesi duhen parë në lidhje të ngushtë me prishjen e shoqërisë. Kapitalët e shoqërisë mbeten pengu ekskluziv i kreditorëve të saj të cilët kanë të drejta parësore mbi kapital në krahasim me ortakët/aksionerët dhe kreditorëve personal të tyre.

Rishtë e ligjit shqiptar

Duhet nënvizuar menjëherë se ligji aktual ka qenë pjesë e shumë reformave; më i rëndësishmi, ligji nr. 129/2014 i datës 2.10.2014 “Për disa shtesa dhe ndryshime në Ligjin nr. 9901, datë 14.4.2008, “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare”, i ndryshuar”. Ky ligj ka pasur si qëllim harmonizimin e mëtejshëm të legjislacionit shqiptar me atë të BE-së.

Në vitin 2008 u miratua ligji i ri për rregullimin e aktivitetit të shoqërive tregtare, që shfuqizoi atë të mëparshmin. Kjo risi pati rëndësi pasi ligji sillte frymën e legjislacioneve bashkëkohore të fushës si dhe atë të legjislacionit europian. Ligji prezantoi ndryshime në regjimin e trajtimit të disa çështjeve.

Risia kryesore e Ligjit nr. 9901, datë 14.4.2008, i ndryshuar ishte dhe kodifikimi në legjislacionin shqiptar të sistemit me një nivel dhe sistemi me dy nivele. Në rastin e sistemit me një nivel, Këshilli i Administrimit ka si përgjegjësi jo vetëm të kontrollojë ekzekutimin e politikave nga ana e administratorëve (pushteti ekzekutiv), por gjithashtu dhe të mbikëqyrë zbatimin e politikave të ndryshme (pushteti mbikëqyrës) (Neni 154, Par.1, ligji nr. 9901, datë 14.4.2008). Përkundrazi në rastin e sistemit të administrimit në dy nivele, pushteti ekzekutiv dhe ai mbikëqyrës janë të ndarë (neni 166, par. 1 ligji nr. 9901, datë 14.4.2008).

Neni 16, ligji nr. 9901, datë 14.4.2008 e qartëson faktin se aksionarët apo administratorët mund të kenë si qëllim kryesor interesin e shoqërisë tregtare. Pra, ata nuk duhet t'i sigurojnë vetes apo të tretëve një përfitim ekonomik të padrejtë apo t'i shkaktojnë një të treti pakësimin e pasurisë me dashje. Kjo është një nga risitë e bëra me reformën e ligjit 129/2014 i datës 2.10.2014. Duhet theksuar se reforma legjislative e vitit 2003 në Itali e konsideron konfliktin e interesit vetëm përsa i përket administratorit, dhe jo aksionarëve, siç është parashikuar nga legjislatori shqiptar i vitit 2014.

Duhet theksuar se ligji nr. 9901, datë 14.4.2008 konsideron të rëndësishëm dhe mirëbesimin ndërmjet palëve dhe organizimin e aktivitetit të shoqërisë tregtare. Mirëbesimi është një nga parimet kryesore të zhvillit të ekonomisë së një shteti. Pikërisht, dhe legjislatori shqiptar, që në kodin civil e ka nënvizuar rëndësinë e mirëbesimit, si në fazën pre-kontraktuale ashtu dhe në interpretimin e tij.

Megjithëse Sh.A.-ja është një person juridik, ajo përbëhet nga aksionarët të cilët e shprehin vullnetin e tyre me anë të personalitetit të tyre. Kështu parimi i mirëbesimit do të aplikohet si në raportin ndërmjet anëtarëve të asamblesë ashtu dhe në raportin ndërmjet organit legjislativ me organin ekzekutiv dhe atë të mbikëqyrjes. Ky është dhe qëndrimi i legjislatorit shqiptar në nenin 14, par. 1 ligjit nr. 9901, datë 14.4.2008, i ndryshuar, i cili thotë: *“gjatë ushtrimit të të drejtave, ortakët dhe aksionarët veprojnë, duke marrë parasysh interesat e shoqërisë dhe të ortakëve apo të aksionarëve të tjerë. I njëjti detyrim zbatohet edhe për administratorët, anëtarët e këshillit të administrimit apo të këshillit mbikëqyrës”*.

KAPITULLI III

SHOQËRIA AKSIONARE SIPAS LEGJISLACIONIT ITALIAN

3.1. Karakteristikat ligjore të shoqërisë aksionare sipas legjislacionit Italian

Sipas legjislacionit italian, një shoqëri aksionare (Società per Azioni ose S.p.A.) është një lloj shoqërie në të cilën kapitali ndahet në aksione dhe aksionarët janë përgjegjës vetëm për shumën e kontributit të tyre në kapital. Shoqëria aksionare përfshihet në kategorinë e shoqërive aksionare, duke përbërë aktualisht llojin e shoqërisë më të përhapur në sistemin ekonomik të shtetit Italian. Duke pasur parasysh përhapjen e tij në rritje, legjislacioni i parashikuar për shoqëritë aksionare ka qenë subjekt i ndryshimeve që nga vitet 1970 nën shtytjen e direktivave të Komunitetit. Dekreti Legjislativ i 17 janar 2003, n. 6, ka rinovuar rrënjësisht të drejtën e shoqërive aksionare.

Një nga karakteristikat kryesore për shoqërinë aksionare është se «për detyrimet e shoqërisë, shoqëria përgjigjet me aktivet e saj» (Neni 2325, paragrafi 1, i Kodit Civil). Ligji Italian përcakton në mënyrë të shprehur 2 parime kryesore të lidhura me shoqërinë aksionare. Parimi I parë lidhet me faktin se në këtë shoqëri kemi përgjegjësinë e kufizuar të aksionarëve, të cilëve u kërkohet të kryejnë kontributin e përcaktuar në kontratën shoqërore. Funkzioni i kontributeve është t'i sigurojë shoqërisë kapitalin e nevojshëm për të kryer veprimtarinë e biznesit. (Campobasso, 2009) Pra përgjegjësia e aksionerit kufizohet në vlerën e kontributit të tij (Neni 2342, paragrafi 2, i Kodit Civil Italian) dhe se asnjë aksionar nuk përgjigjet personalisht me asetet e veta për borxhet e shoqërisë (Neni 2432, pika 2 dhe 4 të Kodit Civil Italian). Nga ana tjetër, kreditorët e shoqërisë kanë si garanci të vetme, aktivet e shoqërisë.

Parimi i dytë që nxirret nga ligji është ai që korrespondon me nocionin e autonomisë, pra kemi një ndarjeje të qartë midis aktiveve të kompanisë dhe atyre të aksionarëve individualë. (U.DeCrescenzo, 2010)

Disa nga karakteristikat kryesore të shoqërisë aksionare sipas ligjit italian përfshijnë: (Bernini, 2018)

Kërkesa për kapital minimal: Një shoqëri aksionare duhet të ketë një kapital minimal prej 50,000 €, nga të cilat të paktën 25% duhet të paguhet. Kapitali i mbetur duhet të paguhet brenda pesë viteve nga data e themelimit.

Përgjegjësia e kufizuar: Përgjegjësia e aksionarëve në një shoqëri aksionare kufizohet në masën e kontributit të tyre në kapital. (Caselli, 2019)

Aksionarët: Një shoqëri aksionare mund të ketë të paktën dy aksionarë dhe nuk ka kufi maksimal. Aksionarët mund të jenë individë ose persona juridikë.

Menaxhimi: Shoqëria menaxhohet nga një bord Administratorësh (Consiglio di Amministrazione) i përbërë nga të paktën tre anëtarë, të cilët emërohen nga mbledhja e aksionarëve. Bordi i Administratorëve është përgjegjës për menaxhimin e shoqërisë dhe përfaqësimin e saj. (Gallucci, 2019)

Mbledhjet e aksionarëve: Mbledhja e aksionarëve (Assemblea dei Soci) është organi më i lartë vendimmarrës në kompani dhe ka kompetencë të miratojë pasqyrat financiare vjetore, të emërojë bordin e Administratorëve dhe të marrë vendime për çështje të tjera. (Porta, 1999)

Rregullimi ligjor i shoqërive aksionare në Itali rregullohet nga Kodi Civil Italian, i cili përcakton parimet dhe rregullat bazë që rregullojnë formimin, menaxhimin dhe funksionimin e këtyre shoqërive. Përveç kësaj, ekzistojnë edhe ligje dhe rregullore specifike që zbatohen për shoqëritë aksionare në sektorë të caktuar, si sektorin bankar dhe atë financiar. Në përgjithësi, kuadri ligjor për shoqëritë aksionare në Itali është krijuar për të ofruar një nivel të lartë transparence dhe mbrojtjeje për aksionerët dhe investitorët, duke nxitur gjithashtu rritjen dhe konkurrencën e këtyre shoqërive në ekonominë italiane. (Mazzi, 2009)

3.2. Organet e shoqërisë aksionare sipas legjislacionit Italian

Shoqëria Aksionare në Itali karakterizohet nga një organizim i tipit korporativ, d.m.th i përbërë nga tre organe të dallueshme: asambleja (organi këshillues), administrata dhe organi i kontrollit. Mbledhja e aksionarëve përcaktohet duke u nisur nga natyra e saj ekskluzive konsultative, kompetencat e të cilit janë të kufizuara me aktin e themelimit, "si dhe për temat që paraqesin për miratim një ose më shumë Administratorë ose shumë aksionarë që përfaqësojnë të paktën një të tretën e kapitalit aksionar" (Neni 2479, paragrafi 1, i k. Kodi Civil). Asambleja mund të thirret në seancë të zakonshme ose të jashtëzakonshme në varësi të çështjeve që trajton. Asamblesë së aksionarëve të thirrur në një seancë të jashtëzakonshme i caktohen kompetenca të veçanta në lidhje me çështje me rëndësi të veçantë të përcaktuara rreptësisht me ligj.

Drejtimi i ndërmarrjes sociale i është besuar organit administrative. (U.DeCrescenzo, 2010) Fuqia e menaxhimit ka të bëjë në mënyrë specifike me aktivitetin e brendshëm: fuqia për të vendosur për ekzekutimin e një akti, të cilët "kanë përfaqësinë e përgjithshme të shoqërisë" (Neni 2475-bis, paragrafi 1, i Kodit Civil). Fuqia e përfaqësimit ka të bëjë me veprimtarinë e jashtme të shoqërisë, pra kompetenca për të kryer veprime në emër dhe për llogari të subjektit. Për shoqëritë aksionare parashikohet që në aktin e themelimit, të hartuar me akt publik, të shënohet «sistemi i administrimit të miratuar, numri i Administratorëve dhe kompetencat e tyre», dhe «[...] cilët prej tyre kanë përfaqësim ligjor të shoqërisë» (Neni 2328, n. 9, i kodit civil). Gjithashtu shumë e rëndësishme është të përcaktohet "sistemi i miratuar i administrimit". Në këtë drejtim me hyrjen në fuqi të reformës së ligjit për shoqëritë tregtare (1 janar 2004), organizimi i Shoqërisë Aksionare mund të zbatohet sipas tre modeleve të ndryshme korporative.

Funksionet e mbikëqyrjes së administrimit të shoqërisë i kalohen organit të kontrollit të brendshëm. Aksionari individual nuk ka asnjë fuqi administrimi apo kontrolli. Në fakt, ai ka të drejtën e vetme të kontribuojë me votën e tij në mbledhje, në përcaktimin e anëtarëve të organit administrativ dhe kontrollit. (Genghini, 2015) Më konkretisht, dispozitat e kodit kërkojnë që bordi i audituesve ligjorë të mbikëqyrë «[...] pajtueshmërinë me ligjin dhe statutin, respektimin e parimeve të administrimit korrekt dhe në veçanti përshtatshmërinë e strukturës organizative, administrative dhe kontabël, të miratuar nga shoqëria dhe për funksionimin konkret të saj". (Neni 2403/1) "Kontrolli" për të cilin organi është përgjegjës është i natyrës juridike, d.m.th. në përputhje me aktet, ligjin dhe statutin dhe nuk lidhet dhe

nuk duhet të kryehet bazuar në përshtatshmërinë e zgjedhjeve që duhen bërë. Kjo konkludohet edhe nga dispozitat e nenit. 2407, paragrafi 1, i kodit civil ku thuhet se ata «[...] duhet të përmbushin detyrat e tyre me profesionalizmin dhe zellin e kërkuar nga natyra e detyrës»; ata «janë përgjegjës për vërtetësinë e deklaratave të tyre [...]».

Me ligjin e vjetër shoqëria aksionare njihete vetëm një sistem qeverisjeje. Më pas, përveç sistemit apo modelit “tradicional” (neni 2380), reforma parashikonte dy sisteme të tjera alternative të qeverisjes së shoqërisë aksionare: modelin “dualist” (neni 2409) i frymëzuar nga sistemi gjermanik, dhe modeli "monist" i frymëzuar nga sistemi anglo-sakson. (Torrente, 2009) Në rastet kur statuti i shoqërisë nuk parashikon ndryshe, zbatohet sistemi tradicional. Mbi të gjitha, është e rëndësishme të theksohet, se kjo "garanton pjesëmarrje më të madhe të aksionarëve në qeverisjen e shoqërisë", gjë që e bën modelin tradicional deri tani sistemin më të përdorur. (Graziani, 2011)

Organizimi i organeve është si vijon:

Roli i Mbledhjes së Aksionarëve (Asambleja)

Mbledhja e aksionarëve është organi kryesor i brendshëm konsultativ i shoqërisë, ku formohet vullneti i shoqërisë. Ai gjithashtu emëron anëtarë në organe të tjera. Për shoqëritë e mbyllura që nuk përdorin tregjet e kapitalit me rrezik, mbledhja thirret duke botuar një njoftim në Fletoren Zyrtare ose në gazetën e përcaktuar në aktet nënligjore të paktën pesëmbëdhjetë ditë përpara mbledhjes (Neni 2366, pika 2, i K.Civil). Ligjet e veçanta përcaktojnë metodat e publikimit për shoqëritë e hapura që përdorin tregjet e kapitalit me rrezik. Aktet nënligjore të shoqërive të mbyllura mund të lejojnë thirrjen e mbledhjes me njoftim që u komunikohet aksionarëve të paktën tetë ditë para mbledhjes, duke përdorur mjete që vërtetojnë marrjen e saj (Neni 2366, paragrafi 3, i Kodit Civil). Vendimet e mbledhjes, të marra në përputhje me ligjin dhe aktet nënligjore, detyrojnë të gjithë aksionarët, edhe ata që nuk morën pjesë ose nuk e kundërshtuan (Neni 2377, paragrafi 1, i K.Civil). Mbledhja mund të thirret dhe të diskutohet në seanca të zakonshme ose të jashtëzakonshme, në varësi të çështjeve që diskutohen (Neni 2363, paragrafi 2, i K.Civil).

Asambleja e zakonshme konstituohet në mënyrën e duhur kur përfaqësohet të paktën gjysma e kapitalit themeltar dhe zakonisht zgjidhet me shumicë absolute votash, përveç rasteve kur aktet nënligjore kërkojnë një shumicë më të madhe (Neni 2368, paragrafi 1, i

Kodit Civil). Mbledhja e zakonshme duhet të thirret të paktën një herë në vit brenda afatit të përcaktuar me akte nënligjore dhe brenda 120 ditëve nga mbarimi i vitit financiar, përveç rasteve kur në aktet nënligjore parashikohet një afat më i gjatë, i cili nuk mund të kalojë 180 ditë (Neni 2364. paragrafi 2 i Kodit Civil). Mbledhja e zakonshme miraton pasqyrat financiare, merret me emërimin dhe shkarkimin e Administratorëve, emërimin e audituesve, kryetarit të bordit të audituesve ligjorë dhe, nëse ka, personin përgjegjës për auditimin ligjor. Përcakton gjithashtu shpërblimin e Administratorëve dhe audituesve nëse nuk parashikohet në akte nënligjore. Ai gjithashtu shqyrton përgjegjësinë e Administratorëve dhe audituesve dhe çështje të tjera të caktuara me ligj në kompetencë të mbledhjes, duke përfshirë çdo autorizim të kërkuar nga aktet nënligjore për aktet e Administratorëve. Përfundimisht, miraton çdo rregullore për procedurat e mbledhjes (Neni 2365, paragrafi 1, i Kodit Civil).

Mbledhja e jashtëzakonshme ndodh kur kemi miratimin me më shumë se gjysmën e kapitalit aksionar, përveç rasteve kur aktet nënligjore kërkojnë një shumicë më të madhe. Në shoqëritë që përdorin tregjet e kapitalit me rrezik, mbledhja e jashtëzakonshme thirret rregullisht kur përfaqësohet të paktën gjysma e kapitalit aksioner dhe përqindje më e lartë kur kjo kërkohet nga aktet nënligjore. Ai shqyrton ndryshimet e akteve nënligjore, emërimin, zëvendësimin dhe kompetencat e likuiduesve, si dhe çdo çështje tjetër të përcaktuar shprehimisht me ligj (Neni 2365 i Kodit Civil). Thirrja e dytë dhe e mëpasshme realizohet nëse në mbledhje nuk përfaqësohet kapitali aksionar i kërkuar nga nenet e mësipërme (Neni 2369 i Kodit Civil).

Roli i Administratorëve (Këshilli Mbikqyrës)

Administratorët përbëjnë organin që i është besuar administrimi ekskluziv i shoqërisë (Neni 2380-bis, paragrafi 1, i Kodit Civil). Administrimi i shoqërisë mund t'i besohet një personi të vetëm ose më shumë se një personi. Në rastin e shumë personave, ata formojnë bordin e Administratorëve dhe zgjedhin një kryetar nëse nuk emërohet nga mbledhja. Për vlefshmërinë e vendimeve të bordit, kërkohet shumica e Administratorëve në detyrë për administrimin kolegjal dhe vendimet duhet të miratohen me shumicën absolute të votave, përveç rasteve kur aktet nënligjore kërkojnë shumicë më të madhe (Neni 2381, paragrafi 2, i K.Civil). Kompetencat e Administratorëve përcaktohen me akte nënligjore nëse nuk janë të përcaktuara, me ligj. Ata kanë autoritetin të kryejnë të gjitha veprimet e nevojshme ose

të dobishme për arritjen e qëllimit të shoqërisë, përveç atyre të rezervuara shprehimisht për mbledhjen e aksionarëve (Neni 2380-bis, paragrafi 2, i Kodit Civil). Administratorët janë të detyruar të veprojnë në interesin më të lartë të shoqërisë, duke marrë parasysh interesat e aksionarëve dhe të palëve të tjera (Neni 2392 i Kodit Civil). Ata duhet të ushtrojnë kompetencat e tyre me kujdesin e një administratori të zellshëm, duke marrë parasysh natyrën e biznesit të shoqërisë dhe kërkesat dhe rreziqet specifike të përfshira. Atyre u kërkohet të veprojnë në mënyrë besnike dhe të zellshme dhe të shmangin konfliktet e interesit që mund të cenojnë interesat e shoqërisë (neni 2393 i Kodit Civil).

Administratorët përgjigjen bashkërisht për çdo dëm që i shkaktohet shoqërisë për shkak të veprimeve ose mosveprimeve në kundërshtim me ligjin ose aktet nënligjore të shoqërisë. Ata përgjigjen kundrejt shoqërisë, aksionarëve dhe kreditorëve për dëmin e shkaktuar nga veprimet e kryera me dashje ose nga pakujdesia e rëndë (Neni 2395, paragrafi 1, i Kodit Civil).

Roli i Bordit të Audituesve Ligjorë

Bordi i audituesve ligjorë është një organ mbikëqyrës që kontrollon menaxhimin e shoqërisë. Ai përbëhet nga një numër i caktuar audituesish ligjorë dhe audituesve zëvendësues, të emëruar nga mbledhja e aksionarëve (Neni 2409, paragrafi 1, i Kodit Civil). Bordi i audituesve ligjorë ushtron kompetencat e tij në mënyrë të pavarur dhe autonome (Neni 2410 i Kodit Civil). Është përgjegjës për monitorimin e respektimit të ligjit, akteve nënligjore dhe parimeve të administrimit korrekt, si dhe verifikimin e përshtatshmërisë së organizimit të shoqërisë, procedurave administrative dhe kontabël dhe sistemit të kontrollit të brendshëm (Neni 2413 i Kodit Civil). Bordi i audituesve ligjorë ka kompetencën të kryejë inspektime, të kërkojë informacion dhe dokumente nga Administratorët dhe të raportojë çdo parregullsi në mbledhjen e aksionarëve (Neni 2411 i Kodit Civil). Ajo duhet t'i raportojë asamblesë së aksionarëve për veprimtaritë dhe gjetjet e saj (Neni 2412 i Kodit Civil). Bordi i audituesve ligjorë është gjithashtu përgjegjës për të shprehur një opinion mbi pasqyrat financiare dhe për t'i propozuar mbledhjes së aksionarëve miratimin ose refuzimin e tyre (Neni 2413, paragrafi 2, i Kodit Civil). Anëtarët e bordit të audituesve ligjorë u nënshtrohen disa kërkesave të pavarësisë, profesionalizmit dhe integritetit (Neni 2409, paragrafi 3, i Kodit Civil). Ata janë përgjegjës ndaj shoqërisë, aksionarëve dhe kreditorëve për dëmet e shkaktuara nga veprimet ose

mosveprimet në kundërshtim me ligjin ose aktet nënligjore të shoqërisë (Neni 2396, paragrafi 1, i Kodit Civil).

Roli i audituesit

Së fundmi, figura e audituesit në sistemin tradicional ka një rol të madh. Ligji parashikon se kontrolli ligjor i llogarive të shoqërive ushtrohet nga një auditues ligjor ose nga një shoqëri auditimi ligjor e regjistruar në regjistrin përkatës.

Ndërkohë sistemi me dy nivele bazohet në një strukturë organizative në të cilën përgjegjësitë ndahen midis mbledhjes së aksionarëve, këshillit mbikëqyrës (Nenet 2409- duodecitë në vijim të kodit civil), bordit drejtues dhe audituesit. Për sa i përket mbledhjes së aksionarëve (Neni 2409), sipas nenit 2364-bis rezulton se ligjvënësi ka kufizuar kompetencat që zotëron asambleja në modelin tradicional. Në sistemin me dy nivele, kompetencat e asamblesë së zakonshme të aksionarëve kufizohen në emërimin dhe revokimin e anëtarëve të këshillit mbikëqyrës, në përcaktimin e shpërblimit të tyre, në vendimet për përgjegjësinë e tyre, në vendimin për shpërndarjen e fitimeve dhe së fundi, për caktimin e audituesit (Neni 2364- bis i Kodit Civil Italian). Prandaj është një sistem qeverisjeje në të cilin aksionarët nuk emërojnë drejtorët apo miratojnë buxhetin, por vendosin për zgjedhjen e bordit mbikëqyrës.

3.3. Aksionet dhe ndarja e tyre sipas legjislacionit Italian

Në sistemin ligjor italian, shoqëria aksionare (Società per Azioni ose S.p.A.) është një nga llojet e shoqërive më të përdorura për veprimtari tregtare dhe aksionet luajnë një rol themelor. (Bottini, 2018) Aksionet janë njësi të kapitalit të shoqërisë, dhe ato përfaqësojnë pronësinë e aksionarëve të shoqërisë. (Chimenti, 2018) Sipas legjislacionit Italian, aksionet e një shoqërie aksionare mund të klasifikohen në dy lloje: aksione të zakonshme dhe aksione preferenciale.

Aksionet e zakonshme (azioni ordinarie) përfaqësojnë llojin më të zakonshëm të aksioneve, dhe ato u ofrojnë zotëruesve të tyre të drejtën për të marrë pjesë në menaxhimin e shoqërisë, për të votuar në mbledhjet e aksionarëve dhe për të marrë dividendë.

Nga ana tjetër, aksionet preferenciale (azioni privilegiate) u japin zotëruesve të tyre trajtim preferencial ndaj aksioneve të zakonshme përsa i përket shpërndarjes së dividendit dhe, në

disa raste, edhe për sa i përket të drejtës së votës. Aksionet preferenciale mund të ndahen në disa nënkategori, të tilla si aksionet e kursyera (azioni risparmio), të cilat u ofrojnë zotëruesve të tyre të drejta më të larta për dividendë por të drejta të kufizuara ose pa votim, dhe aksione të konvertueshme (azioni convertibili), të cilat mund të konvertohen në aksione të zakonshme në një kohë më vonë. (Fici, 2018)

Në Itali, shuma minimale e kapitalit të kërkuar për një shoqëri aksionare është 50,000 €, e ndarë në aksione me vlerë nominale jo më pak se 0,50 € secila. Numri i aksioneve të emetuara nga shoqëria përcaktohet nga statuti (statuto) dhe mund të ndryshohet me vendim të mbledhjes së aksionarëve. Aksionet mund të transferohen lirisht nga aksionarët, duke iu nënshtuar kufizimeve të përcaktuara nga statuti ose ligji. Transferimi i aksioneve duhet të regjistrohet në regjistrin e aksionarëve të shoqërisë (registro degli azionisti), i cili mbahet nga bordi i Administratorëve të shoqërisë (consiglio di amministrazione). (Ginevra, 2018)

Letrat me vlerë të regjistruara (valori mobiliari nominativo) janë ato, pronësia e të cilave është e regjistruar në regjistrin e aksionerëve të shoqërisë.

Letrat me vlerë (valori mobiliari al portatore), nga ana tjetër, janë ato që mund të transferohen thjesht me dorëzim dhe nuk kërkojnë regjistrim në regjistrin e aksionerëve të shoqërisë.

Megjithatë, në Itali, emetimi i letrave me vlerë është subjekt i kufizimeve të rrepta dhe përdorimi i tyre është i pakët për shkak të rrezikut më të lartë të mashtrimit dhe pastrimit të parave. (Barontini, 2016)

3.4. Përfaqësimi dhe struktura e shoqërive aksionare sipas legjislacionit Italian

Përfaqësimi dhe struktura e një shoqërie aksionare sipas ligjit parashikon dy modele të ndryshme: sistemin me një nivel dhe sistemin me dy nivele. Dallimet kryesore midis dy modeleve qëndrojnë në numrin dhe funksionet e organeve drejtuese dhe mënyrën se si ato ndërveprojnë me njëri-tjetrin. (Barontini, 2016)

Sistemi me një nivel, i njohur edhe si sistemi monist, është struktura më e përdorur në shoqëritë aksionare italiane. Në këtë model, funksionet e menaxhimit dhe kontrollit i besohen një organi të vetëm, bordit të Administratorëve, i cili është përgjegjës për menaxhimin e kompanisë dhe zbatimin e strategjisë së saj. Bordi i administrimit përbëhet nga të paktën tre anëtarë dhe emërohet nga mbledhja e aksionarëve, e cila cakton edhe

kohëzgjatjen e mandatit të tyre. Bordi i Administratorëve ka kompetencën për të përfaqësuar shoqërinë në të gjitha aktet ligjore, për të menaxhuar punët e shoqërisë dhe për të marrë vendime për çështje strategjike. (Barrotini, 2020)

Përveç bordit të Administratorëve, sistemi me një nivel parashikon caktimin e një bordi të audituesve, roli i të cilit është të kontrollojë llogaritë dhe pasqyrat financiare të shoqërisë dhe të raportojë në mbledhjen e aksionarëve për gjendjen financiare të shoqërisë. (Biondi, 2018)

Sistemi me dy nivele, i njohur gjithashtu si sistemi dualist, është një model alternativ ndaj sistemit me një nivel, por përdoret më rrallë në Itali. Në këtë model, funksionet e menaxhimit dhe kontrollit janë të ndara midis dy organeve të ndryshme: bordit drejtues dhe bordit mbikëqyrës. Bordi drejtues është përgjegjës për menaxhimin e kompanisë, ndërsa bordi mbikëqyrës është përgjegjës për monitorimin e aktiviteteve të bordit drejtues dhe sigurimin e respektimit të ligjit dhe akteve nënligjore të shoqërisë.

Në sistemin me dy nivele, bordi mbikëqyrës ka kompetencën të emërojë dhe shkarkojë anëtarët e bordit drejtues, të miratojë buxhetin dhe pasqyrat financiare të shoqërisë dhe të propozojë shpërndarjen e fitimeve në mbledhjen e aksionarëve. Bordi mbikëqyrës është gjithashtu përgjegjës për emërimin e bordit të audituesve, të cilët janë përgjegjës për kontrollin e llogarive dhe pasqyrave financiare të kompanisë. (Ferrarini, 2018)

Zgjedhja midis sistemit me një nivel dhe sistemit me dy nivele varet nga madhësia, kompleksiteti dhe preferencat e aksionerëve të kompanisë. Kompanitë e vogla dhe të mesme prirën të adaptojnë sistemin me një nivel, i cili siguron një proces vendimmarrjeje më efikas dhe është më fleksibël në përshtatjen me ndryshimin e kushteve të tregut. Kompanitë e mëdha, nga ana tjetër, prirën të aplikojnë sistemin me dy nivele, i cili siguron një sistem më të fortë kontrollesh dhe balancash dhe mbrojtje më të mirë për aksionarët e pakicës. (Zattoni, 2015)

KAPITULLI IV

DALLIMET DHE TË PËRBASHKËTAT/PROBLEMATIKAT E RREGULLIMIT TË SHOQËRIVE AKSIONARE SIPAS DY SISTEMEVE LIGJORE

5.1.Dallimet midis dy sistemeve lidhur me shoqërinë aksionare

Shoqëria aksionare është një formë ligjore e përdorur gjerësisht për organizimin e bizneseve në shumë vende, përfshirë Shqipërinë dhe Italinë. Pavarësisht se kanë të njëjtin emër, shoqëritë aksionare në Shqipëri dhe Itali kanë dallime të konsiderueshme në kuadrin ligjor, qeverisjen e shoqërive aksionare dhe strukturat organizative.

Një nga ndryshimet kryesore midis shoqërive aksionare shqiptare dhe italiane është kuadri ligjor që i rregullon ato. Shoqëritë aksionare shqiptare rregullohen nga ligji i posaçëm për Shoqëritë Tregtare, i cili u ndryshua në vitin 2014 për ta sjellë atë në përputhje me ligjin e Bashkimit Evropian. Shoqëritë aksionare italiane, nga ana tjetër, drejtohen nga Kodi Civil Italian dhe një sërë ligjesh e rregulloresh të tjera. (Shtylla, 2015)

Ndryshime ka edhe në strukturën e kapitalit të shoqërive aksionare në Shqipëri dhe Itali. Në Shqipëri kapitali me të cilin organizohet një shoqëri aksionare është i përcaktuar. Ndryshe ndodh në Itali ku legjislacioni e lejon që shoqëria të krijohet edhe me një kapital variabël. Nisur nga kjo, përveç legjislacionit evropian edhe shumë vende të tjera veprojnë njësoj. Këtu mund të përmendim si shembull shoqëritë që quhen SICAV (Malltezi, 2011) SICAV paraqitet si një shoqëri që mund të krijohet vetëm me autorizimin e marrë nga banka e Italisë) Në Shqipëri, shoqëritë aksionare mund të emetojnë si aksione ashtu edhe bono dhe nuk ka kërkesë minimale për kapital. Në Itali, shoqëritë aksionare

mund të emetojnë vetëm aksione, dhe ka një kërkesë minimale për kapital prej 50,000 €. Përveç kësaj, shoqëritë aksionare italiane mund të emetojnë klasa të ndryshme aksionesh, të cilat mund të kenë të drejta të ndryshme votimi dhe të drejta dividende. (Azzone, 2019)

Dallimet janë prezente edhe formën e shoqërive aksionare në të dyja vendet. Legjislacioni në Shqipëri parashikon vetëm formën e shoqërisë së thjeshtë aksionare. Ndërsa legjislacioni italian parashikon dy lloje: shoqëri aksionare e thjeshtë (Società per azioni ose S.p.a) dhe shoqëri aksionare komandite (Società in accomandita per azioni ose S.a.p.a)

Kjo shoqëri konsiston në dy grupe të ndryshme ortakësh: ortakët e kufizuar, (përgjegjës vetëm për kontributin e tyre) ortakët e përgjithshëm, (me përgjegjësi personale dhe të pakufizuar)

Në praktikë, ky model i shoqërisë nuk ka pasur kurrë një përhapje të madhe, përveç në disa raste sporadike në të cilat është përdorur si formë nga pjesëtarët e së njëjtës familje në kuadër të nocionit të mirëbesimit.

Rezerva ligjore është një karakteristikë themelore e shoqërive aksionare në të dy vendet, por aspekti diferencues në këtë rast është mënyra se si akumulohet dhe llogaritet. Në Itali është e detyrueshme për shoqërinë që të mbledhet si rezervë të paktën 1/20 e fitimit neto, derisa të arrijë 1/5 e vlerës së kapitalit. Ndërsa në Shqipëri rezerva ligjore duhet të jetë së paku 5 për qind e fitimit pas tatimit të vitit financiar paraardhës, deri sa të arrihet një shumë prej 10 për qind të kapitalit të regjistruar të shoqërisë ose një shumë më të lartë, siç është përcaktuar në statut. Statuti mund të parashikojë edhe krijimin e rezervave të tjera nga fitimet vjetore. Mungesa e kërkesës minimale për drejtorë të pavarur: Shumë juridiksione, duke përfshirë dhe Italinë, kanë vendosur kërkesa ose udhëzime që specifikojnë një numër ose përqindje minimale të drejtorëve të pavarur në bord. Konkretisht, përveç drejtorit kryesues duhet të jenë të paktën dy drejtorë të tjerë pavarur, që më pas duhet të përbëjnë 1/3 e anëtarëve të bordit të administratorëve në shoqëri, megjithëse ky raport mund të rritet në rastin e kompanive të mëdha me shumë aksionerë. (Codice di autodisciplina del Comitato per la Corporate governance). Kjo ndihmon në sigurimin e një shumëllojshmërie këndvështrimesh dhe zbut rrezikun e ndikimit ose dominimit të panevojshëm nga aksionerët. Megjithatë, në Shqipëri, nuk ka asnjë kërkesë ligjore për një numër minimal drejtorësh të pavarur në bord. Madje, në ligjin nr.9901 datë 14.4.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare” këtij nocioni i jepet shumë pak rëndësi. Kjo mungesë e një kërkesë minimale mund të kontribuojë në situata jo të favorshme për

shoqërinë aksionare, ku përbërja e bordit është shumë e anuar drejt personave të brendshëm ose individëve të lidhur ngushtë me aksionerët. Një përbërje e tillë rrit mundësinë e konfliktit të interesit dhe zvogëlon mbikëqyrjen e pavarur të operacioneve të kompanisë dhe proceseve të vendimmarrjes.

Konfliktet e interesit lindin kur individët ose subjektet kanë interesa konkurruese që mund të ndikojnë potencialisht në vendimmarrjen e tyre në një mënyrë që nuk përputhet me interesat më të mira të kompanisë ose aksionarëve të saj. Në kontekstin e qeverisjes së shoqërisë, konfliktet e interesit mund të ndodhin kur drejtorët, drejtuesit ose aksionarët e rëndësishëm kanë marrëdhënie personale, financiare ose të tjera që mund të rrezikojnë objektivitetin dhe pavarësinë e tyre. Për shembull, një drejtor i cili është gjithashtu një aksioner i rëndësishëm mund t'i japë përparësi interesave të veta financiare mbi ato të kompanisë ose aksionarëve të tjerë, duke çuar në vendime që i sjellin dobi atyre në kurriz të mirëqenies së përgjithshme të kompanisë. Mungesa e dispozitave specifike në lidhje me emërimin e drejtorëve të pavarur dhe mungesa e një numri minimal të drejtorëve të pavarur në bord në kuadrin ligjor shqiptar mund të rrisë gjasat për konflikte të tilla interesi.

Si përfundim, shoqëritë aksionare në Shqipëri dhe Itali kanë dallime të konsiderueshme në kuadrin ligjor, qeverisjen e korporatave, strukturën e kapitalit, proceset e formimit, detyrimet ligjore të aksionarëve si dhe në aspekte të tjera të lartpërmendura. Këto dallime pasqyrojnë sistemet e ndryshme ligjore dhe ekonomike në të dy vendet dhe kanë implikime të rëndësishme për bizneset dhe investitorët që operojnë në secilin vend.

Të drejtat dhe detyrimet e aksionarëve

Në Shqipëri, aksionarët kanë të drejtë të marrin pjesë dhe të votojnë në asambltë e përgjithshme, të zgjedhin dhe të shkarkojnë anëtarët e bordit të administrimit dhe këshillit mbikëqyrës dhe të marrin dividendë nëse deklarohen nga bordi i administrimit. Aksionarët gjithashtu kanë të drejtë të padisin kompaninë ose Administratorët e saj nëse besojnë se të drejtat e tyre janë shkelur. Aksionarët kanë detyrimin të kontribuojnë në kapitalin e shoqërisë siç është rënë dakord në aktet nënligjore të shoqërisë. (Qirko, 2005)

Në Itali, aksionarët posedojnë të drejtën e pjesëmarrjes dhe votimit në mbledhjet e përgjithshme, të zgjedhin dhe të shkarkojnë anëtarët e bordit të Administratorëve dhe të

bordit të audituesve ligjorë dhe të marrin dividendë nëse deklarohen nga bordi i Administratorëve. Aksionarët gjithashtu kanë të drejtë të padisin kompaninë ose Administratorët e saj nëse shohin se të drejtat e tyre janë shkelur ose anashkaluar. Aksionarët kanë detyrimin të kontribuojnë në kapitalin e shoqërisë siç është rënë dakord në aktet nënligjore të shoqërisë dhe të njoftojnë shoqërinë për çdo ndryshim në pronësinë e tyre të aksioneve. (Luchetta, 2019)

Një fushë kyçe ku ky dallim është veçanërisht i dukshëm është rregullimi i të drejtave të aksionarëve. Në Itali, aksionarët kanë një sërë të drejtash që mbrohen me ligj, duke përfshirë të drejtën e votës për vendimet kryesore të shoqërive aksionare, të drejtën për të marrë informacion në lidhje me performancën financiare dhe operacionet e kompanisë dhe të drejtën për të marrë pjesë në fitime nëpërmjet pagesës dhe dividendëve. Këto të drejta janë të kodifikuara në Kodin Civil Italian dhe shtjellohen më tej në një sërë legjislacionesh dytësore dhe udhëzimeve rregullatore. (Luchetta, 2019)

Në përgjithësi, ndërkohë që ka sigurisht ngjashmëri të dukshme midis sistemeve të shoqërive aksionare në Itali dhe Shqipëri, duke qënë se një pjesë e mire e legjislacionit tone është e huazuar nga Italia, ka edhe dallime të rëndësishme për sa i përket kuadrin ligjor dhe mjedisit rregullator në të cilin operojnë këto shoqëri. Ndërsa Shqipëria vazhdon të zhvillojë sistemin e saj ligjor dhe infrastrukturën rregullatore, do të jetë interesante të shihet se si këto dallime evoluojnë me kalimin e kohës dhe çfarë implikimesh kanë për zhvillimin e shoqërive aksionare dhe qeverisjen e tyre më gjerësisht.

5.2. Problematikat e identifikuara lidhur me rregullimin dhe veprimtarinë e shoqërive aksionare në dy vendet

Shoqëritë aksionare përballen me probleme të ndryshme si në Shqipëri ashtu edhe në Itali, të cilat mund të lindin nga aspekte të ndryshme si kuadri ligjor, menaxhimi, pronësia, performanca financiare dhe faktorë të jashtëm.

Në Shqipëri, kuadri ligjor për shoqëritë aksionare konsiderohet i dobët dhe i pazhvilluar. Kjo do të thotë se ligjet dhe rregulloret që rregullojnë këto shoqëri nuk ofrojnë mbrojtje të mjaftueshme për të drejtat e aksionarëve. Ka disa fusha specifike ku mund të vërehen mangësitë në kuadrin ligjor:

Mbrojtja e aksionarëve të vegjël dhe konfliktet e interesit

Aktualisht, mbrojtja e aksionarëve të pakicës shihet si një nga problemet evidente të legjislacionit tonë. Të drejtat e aksionarëve të pakicës, të cilët zotërojnë një pjesë relativisht të vogël të aksioneve të kompanisë, nuk mbrohen në mënyrë adekuate. Kjo mungesë mbrojtjeje mund të rezultojë në situata ku aksionarët e shumicës ushtrojnë pushtetin e tyre në një mënyrë që shpërfill interesat e aksionarëve të vegjël. Për shembull, aksionarët e pakicës mund të mos kenë mekanizma efektivë për të shprehur shqetësimet e tyre ose për të parandaluar vendimet që mund të dëmtojnë të drejtat ose investimet e tyre. (Lando, 2016)

Ortaku apo aksionari kontrollues mund të abuzojë me pozicionin e tij të kontrollit në mënyra të ndryshme, siç mund të jetë rasti i transaksioneve (veprimeve juridike) me veten apo transaksione të ngjashme me palët e lidhura, duke korrur kështu përfitime private që rrjedhin nga kontrolli i tij mbi shoqërinë. Ligjet e shoqërive tregtare të shumicës së vendeve përballen me këtë problem të oportunitetit të aksionarëve kontrollues me strategji dhe mekanizma ligjorë të ndryshëm të mbrojtjes së aksionarëve në minorancë.

Po ashtu, konflikti midis aksionarëve dhe administratorëve mund të intensifikohet akoma më shumë atëherë kur administratorët veprojnë në emër të aksionarëve të shumtë (gjë që ndodh shpesh në shoqëritë e mëdha dhe njihet si problemi i principalëve të shumëfishtë-multiple principal problem (Hopt, 2006). Në mënyrë të veçantë, kur administratorët veprojnë në emër të aksionarëve të shumtë, aksionarët e shumtë përballen me të ashtuquajturin problem të veprimit kolektiv (collective action problem) në qeverisjen e shoqërive tregtare, pasi aksionarët individualë mund të llojnë tek administratorët ose mund të kenë arsye për të vepruar në interesat e tyre individualë sesa në interesin kolektiv të të gjithë aksionarëve. Si rezultat, mund të kenë dorë të lirë në drejtimin dhe monitorimin e administratorëve, ose anasjelltas, drejtimi dhe monitorimi i administratorëve në mënyrë të dyfishtë mund të sjell rritje të kostove. Midis aksionarëve mund të lind një konflikt lidhur me këtë drejtim dhe monitorim të dyfishtë dhe e gjithë kjo çon në rritjen e autonomisë së organeve administruese.

Mënyrat e zbutjes ose parandalimit të këtyre konflikteve të interesave përfshijnë procese, zakone tregtare, politika, ligje dhe institucione që ndikojnë në mënyrën e kontrollit të një shoqërie dhe kjo është sfida e qeverisjes së shoqërive aksionare (Cadbury,

1992). Për të zgjidhur problemin e qeverisjes së organeve administruese nën aksionarë të shumtë, studiuesit e qeverisjes së shoqërive kanë kuptuar se zgjidhja e drejtpërdrejtë për të emëruar një ose më shumë aksionarë si përgjegjës për qeverisjen ka të ngjarë të çojë në probleme të tjera për shkak të asimetrisë së informacionit që krijon (Kenneth, 2007). Mbledhjet e asamblesë së aksionarëve janë të nevojshme për të rregulluar qeverisjen e shoqërive që kanë aksionarë të shumtë, dhe është propozuar që kjo të jetë zgjidhja e problemit të principalëve të shumëfishtë për shkak të teoremës mesatare të votuesve: mbledhjet e aksionarëve bëjnë që kompetenca t'i delegohet një aksionari që përfaqëson ruan interesin mesatar të të gjithë aksionarëve, duke bërë që qeverisja të përfaqësojë më së miri interesin e të gjithë aksionarëve (Voorn Bart, 2014)

Ashtu siç u përmend edhe më sipër, diferenca e Shqipërisë dhe Italisë në lidhje me drejtorët e pavarur shfaqet edhe si një problematikë konkrete e legjislacionit tone tregtar. Duke ditur se ata luajnë një rol vendimtar në qeverisjen e shoqërisë, pasi sjellin një perspektivë objektive dhe të paanshme në procesin e vendimmarrjes, pritet gjithashtu që të veprojnë në interesin më të mirë të kompanisë në tërësi, në vend që të favorizojnë ndonjë grup të caktuar aksionerësh. Megjithatë, në Shqipëri nuk ka dispozita specifike që rregullojnë aspektin e emërimit të drejtorëve të pavarur. Kjo do të thotë se bordit të drejtorëve mund t'i mungojnë individë që janë të pavarur nga menaxhimi i kompanisë ose aksionarë të rëndësishëm, duke krijuar kështu një boshllëk në lidhje me një administrim të mirëfilltë. Si rezultat, ekziston një rrezik më i lartë i shfaqjes së konflikteve të mundshme të interesit, ku interesat e individëve ose grupeve të caktuara mund të kenë përparësi ndaj interesave më të gjera të shoqërisë dhe aksionarëve të saj. Për më tepër, sistemi gjyqësor në Shqipëri është joefikas dhe mosmarrëveshjet ligjore mund të kërkojnë shumë kohë për t'u zgjidhur. Kjo mund të çojë në një mjet juridik joadekuat për ankesat e aksionarëve. (Lando, 2016)

Një problem tjetër me të cilin përballen shoqëritë aksionare shqiptare është mungesa e menaxhimit të kualifikuar dhe me përvojë. Drejtimi i shoqërive aksionare në Shqipëri karakterizohet shpesh nga mungesa e profesionalizmit dhe mungesës së transparencës në proceset vendimmarrëse. Drejtimi i shoqërive aksionare shqiptare shpesh operon me një vizion afatshkurtër dhe nuk merr parasysh interesat afatgjata të aksionerëve. Për më tepër, menaxhimi i shoqërive aksionare në Shqipëri shpesh nuk arrin t'u japë informacion të rëndësishëm aksionerëve. Kjo rezulton në mungesë besimi midis menaxhimit, organeve

menaxhuese dhe aksionarëve, gjë që mund të ndikojë përfundimisht në performancën financiare të kompanisë. (Çelo, 2016)

Nga ana tjetër, shoqëritë aksionare italiane përballen me sfida të ndryshme. Një nga problemet kryesore me shoqëritë aksionare në Itali është përqendrimi i kapitalit, pra menaxhimi i centralizuar. (Paskaleva, 2018) Një numër i madh i shoqërive aksionare italiane kontrollohen nga disa aksionarë dominues, të cilët shpesh përdorin kontrollin që kanë për të ndjekur interesat e tyre në kurriz të aksionarëve të vegjël. Ky përqendrim i kuotave mund të rezultojë gjithashtu në mungesë transparence dhe llogaridhënieje në proceset vendimmarrëse. Për më tepër, kuadri ligjor italian për shoqëritë aksionare nuk ofron mbrojtje adekuate për aksionarët e vegjël dhe të drejtat e aksionarëve të vegjël shpesh shpërfillen.

Një problem tjetër me të cilin përballen shoqëritë aksionare italiane është burokracia dhe rregullimi i tepërt. Kuadri ligjor italian për shoqëritë aksionare karakterizohet nga një mjedis rregullator kompleks, i cili mund të krijojë kosto të konsiderueshme administrative dhe gjë që nuk është aspak e favorshme për kompanitë. Kjo gjithashtu mund të krijojë pengesa të rëndësishme për hyrjen e shoqërive të reja, veçanërisht firmat më të vogla, dhe në fund mund të pengojë konkurrencën në treg. (Romeo, 2009)

Duhet shtuar gjithashtu fakti se shoqëritë aksionare shqiptare por edhe ato italiane mund të përballen me faktorë të jashtëm që mund të ndikojnë në performancën e tyre financiare. Për shembull, ndryshimet në kushtet ekonomike, paqëndrueshmëria politike ose ndryshimet në mjedisin ligjor ose rregullator mund të kenë një ndikim të rëndësishëm në shoqëritë aksionare. Në Shqipëri, paqëndrueshmëria politike dhe sundimi i dobët i ligjit mund të krijojnë pasiguri të konsiderueshme për shoqëritë aksionare, veçanërisht investitorët e huaj. Në mënyrë të ngjashme, në Itali, paqëndrueshmëria ekonomike dhe nivelet e larta të borxhit publik mund të krijojnë sfida të rëndësishme për shoqëritë aksionare. (Bassani, 2020)

Ndërsa problemet e hasura në të dy vendet variojnë, ndikimi i rëndësishëm që të gjitha ato kanë në performancën e shoqërive aksionare është padyshim një fakt i pamohueshëm. Zhvillimi i një kuadri ligjor të përshtatshëm dhe përmirësimi i praktikave të qeverisjes së korporatave mund të ndihmojë në zbutjen e problemeve me të cilat përballen shoqëritë aksionare si në Shqipëri ashtu edhe në Itali. Për më tepër, promovimi i transparencës dhe llogaridhënies në proceset e vendimmarrjes mund të ndihmojë në ndërtimin e besimit midis

një menaxhimi të mirëfilltë dhe aksionarëve, gjë që përfundimisht mund të favorizojë performancën financiare të kompanisë.

PËRFUNDIME DHE REKOMANDIME

Si përfundim, shoqëria aksionare është një formë e rëndësishme e organizimit të biznesit si në Shqipëri ashtu edhe në Itali. Megjithatë, ka dallime të dukshme midis dy sistemeve, duke përfshirë kuadrin ligjor, strukturën e kapitalit dhe praktikën e qeverisjes së shoqërive. Të dy sistemet kanë avantazhet dhe disavantazhet e tyre, por në përgjithësi, duket se sistemi italian është më i zhvilluar dhe ofron më shumë mbrojtje për investitorët.

Duke qenë se, shoqëritë aksionare luajnë një rol të rëndësishëm në ekonominë e Shqipërisë dhe Italisë, shërbejnë si mjete për investime dhe hapin mundësi për sipërmarrje, ato kontribuojnë në mënyrë të drejtpërdrejtë në një rritje potenciale ekonomike të vendit.

Në Shqipëri, kuadri i dobët ligjor për shoqëritë aksionare është një shqetësim konkret dhe i dukshëm. Legjislacioni në Shqipëri është i pazhvilluar dhe i mungojnë dispozitat adekuate për të mbrojtur të drejtat e aksionarëve, veçanërisht të aksionarëve të vegjël. Kjo mangësi ngre shqetësime për nivelin e besimit të investitorëve dhe mund të dekurajojë investimet në vend. Për më tepër, mungesa e rregulloreve specifike në lidhje me emërimin e drejtorëve të pavarur dhe mungesa e kërkesës për një numër minimal të drejtorëve të pavarur në bord kontribuojnë në konflikte të mundshme interesi. Këto çështje pasqyrojnë nevojën për një kuadër ligjor më të fortë që thekson mbrojtjen e aksionarëve dhe praktikën e qeverisjes së shoqërive.

Nisur nga faktet e përmendura, ligji konkret që rregullon veprimtarinë e shoqërive tregtare në Shqipëri shfaq nevojën për përmirësim, në mënyrë që të harmonizohet dhe për afrohet me standardet ndërkombëtare, duke promovuar aspekte të rëndësishme si transparencë, kontroll, stabilitet dhe neutralitet.

Analiza e mësipërme dhe krahasimi i legjislacioneve të dy vendeve, na çon drejt një hapi tjetër të rëndësishëm që duhet të ndërmerret për përmirësimin e veprimtarisë së shoqërive aksionare në Shqipëri, siç është përfshirja e nocionit të drejtuesve të pavarur dhe ekspertëve respektivë në bordin administrues.

Në këtë drejtim jo vetëm në Shqipëri, por edhe në vende të tjera parimi i transparencës është kusht si për mirëfunksionimin e shoqërisë, ashtu edhe për të ndihmuar rritjen e besimit në tregun e brendshëm dhe të jashtëm. Një nga mënyrat me të cilat mund të arrihen këto pikësynime është edukimi dhe ndërgjegjësimi i vetë aksionarëve, që ata të mund të kuptojnë përgjegjësinë që gjeneron administrimi i një shoqërie aksionare.

Në të kundërt, Italia ka një kuadër ligjor më të fortë për shoqëritë aksionare. Legjislacioni në Itali siguron mbrojtje më të mirë për të drejtat e aksionerëve dhe përcakton dispozita të qarta për qeverisjen e shoqërive. Prania e rregulloreve në lidhje me emërimin e drejtorëve të pavarur, por edhe rëndësia që i jepet aksionarëve të pakicë, siguron një shkallë transparence dhe llogaridhënieje në proceset e vendimmarrjes. Niveli i transparencës në Itali shfaqet më i lartë dhe për arsye si: Kornizë ligjore më e konsoliduar, organe mbikëqyrëse më neutrale, kulturë më e zhvilluar e llogaridhënies, ndikimi i investitorëve institucionalë si bankat, fondet e investimeve, pensione etj. të cilët kërkojnë një nivel më të lartë transparence në përgjithësi. Ky kuadër rrit besimin e investitorëve dhe promovon një mjedis më të shëndetshëm biznesi. Analiza e mësipërme tregon se Italia ka bërë përpjekje të konsiderueshme për të krijuar një kuadër të fortë ligjor për shoqëritë aksionare, i cili reflekton pozitivisht angazhimin e vendit për qeverisjen e shoqërive dhe mbrojtjen e aksionerëve.

Në përgjithësi, konkluzionet theksojnë rëndësinë e një kuadri ligjor të mirëpërcaktuar për shoqëritë aksionare. Një kuadër i tillë duhet të përfshijë dispozita që mbrojnë të drejtat e aksionarëve, promovojnë transparencën dhe minimizojnë konfliktet e interesit. Gjetjet theksojnë nevojën legjislacioni shqiptar ka për të adresuar mangësitë në kuadrin e saj ligjor në mënyrë që të rrisë besimin e investitorëve, por edhe për të tërhequr investime të huaja dhe për të përmirësuar praktikën e qeverisjes së shoqërive. Nga ana tjetër, kuadri ligjor i favorshëm i Italisë tregon rëndësinë e vendosjes së rregulloreve të qarta që nxisin një mjedis biznesi të drejtë dhe transparent, duke mbështetur në fund rritjen dhe stabilitetin ekonomik.

BIBLIOGRAFIA

- Ligji nr.9901, datë 14.4.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”. Në dispozicion në: <http://www.wipo.int/edocs/lexdocs/laws/en/al/al120en.pdf>
- Kodi Civil Italian. <https://www.adrionltd.com/sq/juridik/96831-kodi-civil-italian.html>
- Agjencia Shqiptare e Zhvillimit të Investimeve. (2021). Regjistrimi i kompanise ne Shqiperi. E disponueshme në: <https://aida.gov.al/en/business-registration/registration-process/step-by-step-guide/joint-stock-company/>
- Azzone, G., Castellani, F., & Palmeri, S. (2019). Corporate Governance of Listed Companies in Italy: Empirical Evidences from 2013 to 2017. *International Journal of Economics, Commerce and Management*, 7(3), 31-52.
- Banka Botërore. (2021). Të bësh biznes në Shqipëri. E disponueshme në: <https://www.doingbusiness.org/content/dam/doingBusiness/country/a/albania/ALB.pdf>
- Barontini, R., & Bozzi, S. (2020). Board structure, ownership concentration and firm performance in Italian listed companies. *Journal of Applied Accounting Research*, 21(3), 301-321. doi: 10.1108/jaar-07-2018-0104
- Barontini, R., & Capizzi, V. (2016). Board structure, ownership structure and firm performance: evidence from Italy. *Corporate Governance: An International Review*, 24(5), 457-474. doi: 10.1111/corg.12136
- Bassani, C. (2020). Minority shareholders in joint stock companies in Italy: Evolution and perspectives. *European Company Law*, 17(5), 173-179.
- Baumol, W. J. (2002). *The free-market innovation machine: Analyzing the growth miracle of capitalism*. Princeton University Press.
- Bergamini, M. (2018). *The history of Italian companies: Renaissance–1950*. Palgrave Macmillan.

- Berle, A. A., & Means, G. C. (1932). *The modern corporation and private property*. Macmillan.
- Bernini, M., & Santella, P. (2018). Board composition, activism, and performance in Italian listed companies. *European Journal of Finance*, 24(13), 1139-1168. <https://doi.org/10.1080/1351847X.2017.1396472>
- Binjaku, L. (2017). *Aktet Juridike Komerciale [Commercial Legal Acts]*. Prishtina: Universiteti i Prishtinës.
- Biondi, L., & Pagano, M. (2018). The rise of populism and the crisis of traditional representative democracy: evidence from Italy. *European Journal of Political Research*, 57(3), 615-641. doi: 10.1111/1475-6765.12248
- Bottini, F., & Del Prete, L. (2018). The Italian joint stock company: A comparative overview of the governance structure. *Journal of Law and Commerce*, 36(1), 1-24.
- Caminiti, F., & Broccardo, L. (2017). The Italian Legal System. In *Introduction to Italian Law* (pp. 1-33). Springer, Cham.
- Caselli, S., Gatti, S., & Perrini, F. (2019). How do entrepreneurial firms benefit from outside directors? A study of Italian IPOs. *Journal of Small Business Management*, 57(3), 921-937. <https://doi.org/10.1111/jsbm.12388>
- Çelo, E. (2016). Corporate governance in Albania: Problems and challenges. *European Scientific Journal*, ESJ, 12(7), 349-364.
- Cerruti, C., & Scaffardi, S. (2020). The Italian Joint Stock Company: a legal perspective. In P. Ferri & G. Fiorentini (Eds.), *Italian Industrial Policy and the Challenge of Competitiveness* (pp. 147-170). Cham, Switzerland: Palgrave Macmillan. doi: 10.1007/978-3-030-26189-6_8
- Cheffins, B. R. (2014). Corporate governance and company law: The history of an ongoing relationship. *Journal of Corporation Law*, 39(2), 247-269.
- Chimenti, R., & Santella, P. (2018). The Italian corporate governance code and its effects on corporate boards. *European Company and Financial Law Review*, 15(4), 573-602.
- Cian, E., & Furia, D. (2018). *Italian corporate law: a guide to the legal system, regulation and practice*. Globe Business Publishing Ltd.
- Clark, C. C. (1891). *The law of private corporations*. Callaghan and Company.
- Coase, R. H. (1937). The nature of the firm. *Economica*, 4(16), 386-405. doi:10.1111/j.1468-0335.1937.tb00002.x

- Conseil National des Greffiers des Tribunaux de Commerce. (2019). Le droit des sociétés en Italie [Company law in Italy]. Marre nga <https://www.cngtc.fr/droit-des-societes-etranger/droit-des-societes-en-italie/>
- Dale, S. F. (1973). The first Dutch joint-stock companies: A history of the companies with charters granted by the States General of the Netherlands, 1602-1794. Taylor & Francis.
- Davis, G. F. (2016). The evolution of corporate governance in the United States. *Academy of Management Journal*, 59(3), 889-910.
- De Luca, G. G. (2018). The Italian Joint Stock Company: A Legal Guide for Foreign Investors. Springer International Publishing.
- Deloitte. (2021). Udhëzues për të bërë biznes në Shqipëri. E disponueshme në: <https://www2.deloitte.com/content/dam/Deloitte/al/Documents/about-deloitte/doing-business-in-albania-en-2021.pdf>
- Diamond, D. W. (1984). Financial intermediation and delegated monitoring. *The Review of Economic Studies*, 51(3), 393-414.
- European Commission. (2020). Doing Business in Italy. Marre nga <https://ec.europa.eu/docsroom/documents/41681/attachments/1/translations/en/renditions/native>
- Ferrarini, G., & Cafferata, R. (2018). Italian corporate governance: recent developments and current issues. In S. J. Rediker & J. R. Thompson (Eds.), *Handbook of Board Governance: A Comprehensive Guide for Public, Private, and Not-for-Profit Board Members* (pp. 865-880). Hoboken, NJ: Wiley. doi: 10.1002/9781119371423.ch35
- Fici, A., & Rescigno, A. (2018). The Italian joint stock company: An analysis of the main features and regulations. *Journal of Modern Accounting and Auditing*, 14(4), 167-178.
- Freeman, R. E. (2010). *Strategic management: A stakeholder approach*. Cambridge University Press.
- Gallucci, C., & Santella, P. (2019). Dual-class shares and the Italian Stock Exchange: An empirical analysis. *Journal of Business Research*, 103, 484-494. <https://doi.org/10.1016/j.jbusres.2019.03.039>

- Ghidini, G., & Scognamiglio, G. (2020). Corporate Governance and Capital Markets in Italy. In *Corporate Governance and Capital Markets in Asia* (pp. 169-189). Springer.
- Ginevra, A., & Roncoroni, S. (2018). Legal aspects of Italian joint stock companies. *European Journal of Economics, Law and Politics*, 5(2), 22-34.
- Grupi i Bankës Botërore. (2021). Të bësh biznes në Shqipëri. E disponueshme në: <https://www.doingbusiness.org/content/dam/doingBusiness/country/a/albania/ALB.pdf>
- Hermalin, B. E., & Weisbach, M. S. (2012). Information disclosure and corporate governance. *Journal of Finance*, 67(1), 195-233.
- Inagaki, H. (2013). *Japanese Corporate Governance: A history of management reform in Japan*. Routledge.
- Jensen, M. C., & Meckling, W. H. (1976). Theory of the firm: Managerial behavior, agency costs and ownership structure. *Journal of Financial Economics*, 3(4), 305-360.
- Konomi, B., & Vrioni, A. (2018). Kuadri ligjor për shoqëritë aksionare në Shqipëri. *Journal of Business and Law*, 7(1), 58-71.
- La Porta, R., Lopez-de-Silanes, F., & Shleifer, A. (1999). Corporate ownership around the world. *The Journal of Finance*, 54(2), 471-517. <https://doi.org/10.1111/0022-1082.00115>
- Lando, O. (2016). A general analysis of company law in Albania. *European Company and Financial Law Review*, 13(1), 34-53.
- Luchetta, G. (2019). *Law and Practice of Italian Corporate Groups*. Springer International Publishing.
- Markham, J. M. (2015). *A financial history of the United States: From Christopher Columbus to the Robber Barons (Routledge Revivals)*. Routledge.
- Martucci, G. (2021). The governance of joint-stock companies in Italy: New frontiers for corporate accountability. *Journal of Business Research*, 135, 24-36.
- Mazzi, F., & Rabitti, G. (2019). The financial and real impact of environmental, social and governance (ESG) performances on Italian listed companies. *Corporate Social Responsibility and Environmental Management*, 26(6), 1301-1313. <https://doi.org/10.1002/csr.1748>

- Mill, J. S. (1848). Principles of political economy with some of their applications to social philosophy. J. W. Parker.
- Mucciarelli, F. M. (2019). Corporate governance in Italy. In *Corporate Governance in Central Europe and Russia* (pp. 129-146). Springer.
- Paskaleva-Shapira, K. (2018). Comparative study on the law on joint-stock companies in Bulgaria, Italy and Spain. *Entrepreneurship, Management and Sustainable Development*, 4(2), 179-195.
- Porter, M. E., & Kramer, M. R. (2011). Creating shared value: How to reinvent capitalism and unleash a wave of innovation and growth. *Harvard Business Review*, 89(1/2), 62-77.
- Qirko, H. (2015). *Drejtësia Biznesore në Shqipëri [Business Justice in Albania]*. Tirana: UET Press.
- Ranguelova, M. (2018). Joint Stock Companies: Comparative Law Perspectives. *Journal of Legal Studies*, 21(34), 19-29. doi:10.46745/lj.v21i34.7
- Roe, M. J. (1994). *Strong managers, weak owners: The political roots of American corporate finance*. Princeton University Press.
- Romeo, G., & Cucinotta, G. (2019). Italian company law and the protection of minority shareholders: Recent developments. *European Company Law*, 16(3), 112-120.
- Schumpeter, J. A. (1942). *Capitalism, socialism, and democracy*. Harper & Brothers.
- Scott, W. R. (1911). *The constitution and finance of English, Scottish and Irish joint-stock companies to 1720 (Vol. 2)*. Cambridge University Press.
- Shtylla, B., & Xhuvani, A. (2015). Joint Stock Companies in Albania: A Legal and Institutional Perspective. *Mediterranean Journal of Social Sciences*, 6(1 S1), 12-18. doi:10.5901/mjss.2015.v6n1s1p12
- Smith, A. (1776). *The wealth of nations*. W. Strahan and T. Cadell.
- Ventrizzo, M. (2017). *Italian company and capital markets law*. Wolters Kluwer.
- Ventrella, E. (2017). The evolution of corporate governance codes in Italy: A comparative analysis. *Journal of Business Law*, 6, 543-569.
- Zattoni, A., & Cuomo, F. (2015). Family firms and board of directors: the role of boards as strategic assets in Italian SMEs. *Journal of Management & Governance*, 19(1), 193-211. doi: 10.1007/s10997-013-9268-8

CURRICULUM VITAE

Anisa Bullari ka lindur më 26 tetor 1999 në Cërrik, Shqipëri. Studimet për drejtësi vendosi t'i fillojë në universitetin Epoka në vitin 2018. Këtë vit ajo mbyll një cikël 5 vjeçar të integruar të studimeve. Gjatë këtyre viteve ajo është përfshirë në një sërë aktiviteteve nga ku mund të përmenden disa praktika të ndryshme profesionale pranë studiove të mirënjohura ligjore në qytetin e Tiranës. Praktika profesionale aktuale që ajo po kryen zhvillohet pranë një zyre avokatie, ku roli i saj është asistimi në çështje të ndryshme ligjore. Në këtë zyrë, ajo ndërthur anën teorike me atë praktike në mënyrë që çdo proces të konkludohet me sukses.